

VLERËSIMI I QEVERISJES
SË MIRË
TË PUSHTETIT EKZEKUTIV
NË MAQEDONINË E VERIUT
DHE NË RAJON
PËRMES INDEKSIT TË HAPJES



SIPAS MATJES PËR VITIN 2024

© 2025 Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”

Shkup, 2025

Titulli i origjinalit: „Процена на доброто владеење на извршната власт во Северна Македонија и регионот преку Индексот на отвореност според мерењето за 2024 г.“

Botues: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”, Rr. "Franklin Ruzvelt" Nr. 19, Kati 2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Për botuesin: Bardhyl Jashari, Drejtor Ekzekutiv

Autore: Dançe Danillovska-Bajdevska, Drejtore e programeve

Redaktorë: Bardhyl Jashari dhe Dançe Danillovska-Bajdevska

Dizajni: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” (Maqedonia e Veriut)

Përkthimi nga maqedonishtja në shqip: Valon Abdiu

Tirazhi: kopje elektronike

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.51:005.332.5(497.7)"2024"(047.31)
342.51:005.332.5(497-15)"2024"(047.31)

DANILLOVSKA-Bajdevska, Dançe

Vlerësimi i qeverisjes së mirë të pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon përmes Indeksit të hapjes : sipas matjes për vitin 2024 / [autore Dançe Danillovska-Bajdevska ; përkthimi nga maqedonishtja në shqip Valon Abdiu]. - Shkup : Fondacioni për Internet dhe shoqëri Metamorfozis, 2025

Начин на пристапување (URL):

https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2025/10/finalna-analiza_otvorenost-na-izvrsna-vlast_alb-final.pdf.

- Превод на делото: Процена на доброто владеење на извршната власт во Северна Македонија и во регионот преку Индексот на отвореност : според мерењето за 2024 г. - Текст во PDF формат, содржи 55 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 13.10.2025. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-142-4

а) Извршна власт -- Добро владеење -- Индекс на отвореност -- Македонија -- 2024 -- Истражувања б) Извршна власт -- Добро владеење -- Индекс на отвореност -- Западен Балкан -- 2024 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 67208965

Ky dokument politikash është pjesë e projektit të financuar nga Fondi Kombëtar për Demokraci. Përmbytja nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. METODOLOGJIA	7
3. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON NË VITIN 2024.....	10
4. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË VITIN 2024	22
4.1. Përmbledhje për pushtetin ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut	22
4.1.1. TRANSPARENCA	29
4.1.2. QASSHMËRIA	34
4.1.3. INTEGRITETI	42
4.1.4. EFIKASITETI (planifikimi strategjik, raportimi, monitorimi dhe vlerësimi).....	45
5. Rekomandime për pushtetin ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut	52

1. HYRJE

Koncepti i qeverisjes së hapur përfshin një spektër të gjerë politikash dhe praktikash që mundësojnë mënyra të reja qeverisjeje dhe promovojnë qeverisjen e mirë. Hapja, si qasje dhe si vlerë, mundëson vendimmarrje më të mirë, ulje të korrupsionit dhe shërbime më efikase publike për qytetarët. Ndër parimet e saj kryesore janë transparenca, qasshmëria, efikasiteti dhe integriteti, të cilat ofrojnë bazën për kontroll demokratik dhe besim midis institucioneve dhe qytetarëve.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e zgjedhur në qershor të vitit 2024, është zotuar ta "bazojë punën e administratës publike në parimet e efikasitetit, transparencës, profesionalizmit, llogaridhënies dhe disponueshmërisë së shërbimeve"¹. Vazhdoi praktika e zgjedhjes së një Zëvendëskryeministri Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë në kuadër të Qeverisë, mandati i të cilit përfshin, ndër të tjera, rritjen e transparencës së institucioneve, veçanërisht në vendimmarrjen nga Qeveria, si dhe ripërtëritjen dhe thellimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile².

Nga Komisioni Evropian në Raportin³ për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024, u konstatua se duhet të zbatohen reforma thelbësore që lidhen me Bashkimin Evropian (BE). U arrit në përfundimin se funksionimi i institucioneve demokratike është përgjithësisht i kënaqshëm. Megjithatë, u vu në dukje polarizimi në shoqëri në periudhën para zgjedhjeve në prill dhe maj të vitit 2024. Maqedonia e Veriut është angazhuar në mënyrë aktive në zbatimin e Planit të ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, nga i cili mund të përfitojë nga një shpërndarje indikative prej 750,4 milionë eurosh, por ofrimi i mbështetjes së Bashkimit Evropian do të kushtëzohet me përmbushjen e parakushteve dhe zbatimin e reformave siç përcaktohet në Agjendën e Reformave.

Maqedonia e Veriut ka vazhduar përpjekjet e saj për të forcuar demokracinë, ndërkohë që në të njëjtën kohë ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar një qasje të qëndrueshme për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e politikave në nivel kombëtar dhe lokal. Është vënë re se transparenca buxhetore në Maqedoninë e Veriut vazhdon të jetë e kufizuar. Edhe këtë vit përsëritet⁴ se Qeveria duhet t'i rrisë përpjekjet e saj për të përfshirë shoqërinë civile në fushat prioritare dhe në aktivitetet konsultative, në mënyrë që organizatat e shoqërisë civile të kenë një rol të rëndësishëm në procesin e reformës dhe të përfshihen në proceset e vendimmarrjes.

Kur bëhet fjalë për hapjen praktike të pushtetit ekzekutiv në procesin e vendimmarrjes, progresi është i kufizuar. Seancat e qeverisë ende nuk janë të hapura për publikun, as nuk transmetohen, ndërsa publikimi i procesverbaleve pas seancave nuk ofron informacion të

¹ Programi për punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://vlada.mk/strateshki-prioriteti?ln=mk>

² Plani Vjetor i Punës i Zyrës së Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë për vitin 2025, Shkup, shkurt 2025.

³ Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024. Sekretariati për Çështje Evropiane. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2024_en

⁴ Po aty.

mjaftueshëm për mënyrën se si merren vendimet. Pavarësisht termit të përdorur shpesh "transparencë proaktive", qytetarët ende nuk kanë qasje sistemore në atë se si punon Qeveria përpara se të merren vendimet.

Në kuadër të matjes së këtij viti të Indeksit të hapjes (2024), ashtu si edhe vitin e kaluar, Qeveria e Maqedonisë së Veriut është institucioni më i hapur midis grupeve të pushtetit ekzekutiv, ministrive dhe organeve të administratës shtetërore, duke përmbyshur 77,32% të kritereve. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur një rënie minimale prej 1%, gjë që përsëritet për të dytin vit radhazi. Megjithatë, në nivel rajonal, ku hapja mesatare e qeverive është 60,17%, Maqedonia e Veriut mban vendin e parë për të gjashtin vit radhazi, gjë që përputhet me angazhimin e Qeverisë për digjitalizimin e proceseve institucionale me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies më të madhe, veçanërisht në menaxhimin e financave publike.

Ajo që u konstatua në disa ciklet e fundit të matjes, përmes Indeksit të Hapjes, për sa i përket progresit në hartimin e dokumenteve strategjike⁵ në fushën e transparencës dhe hapjes në Maqedoninë e Veriut, për fat të keq, kjo nuk ndikon në progres. Monitorimi i Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me plan veprimi 2023-2026, i kryer nga Fondacioni "Metamorfozis", tregon se aktivitetet e planifikuara po zbatohen vetëm me iniciativën e institucioneve, e jo si një veprim i organizuar⁶. Për më tepër, brengos konkluzioni përfundimtar i monitorimit, i cili është se zbatimi i Strategjisë për Transparencë ka ngecur në pjesën më të madhe të periudhës së zbatimit të saj. Nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve në Planin e Veprimit, vetëm një është zbatuar plotësisht pas përfundimit të vitit të parë të zbatimit.

Në këtë dokument, prezantohen rezultatet kryesore të hulumtimit për hapjen e pushtetit ekzekutiv në periudhën 2024/2025. Duke qenë se hapja është një kusht kyç për demokracinë, pasi u mundëson qytetarëve të marrin informacionin dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efikase dhe llogaridhënie të institucioneve për politikën që ato i zbatojnë, në këtë dokument, duke u bazuar në analizën e situatës, ofrohen rekomandime për institucionet se si ta përmirësojnë performancën e tyre. Duke e respektuar parimin e transparencës, rezultatet janë të disponueshme për publikun dhe së bashku me rekomandimet synojnë përmirësimin e llogaridhënies dhe rritjen e besimit në institucione.

Qeveria, ministritë, por edhe çdo institucion veç e veç, mund të udhëhiqen nga Indeksi i Hapjes dhe ta përdorin atë si një mjet për ta avancuar qeverisjen e tyre të mirë. Fokusi i institucioneve duhet të jetë në publikimin proaktiv të të gjitha dokumenteve në formatin më të hapur të disponueshëm. Si pasojë, faqet e internetit duhet të zënë një pozicion qendror në të gjitha politikën e hapjes së institucioneve me qëllim që ta përmirësojnë disponueshmërinë, si dhe cilësinë e informacionit dhe të dhënave.

⁵ Strategjia për Transparencë e Qeverisë për periudhën 2023-2026, seanca e 121-të e Qeverisë, 24.01.2023, Informacion mbi nevojën për përgatitjen e Strategjisë për Transparencë me Plan Veprimi (2023-2026) të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në <https://vlada.mk/vladini-sednici?page=1>

⁶ Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV-së (2023-2025), për periudhën janar 2024-janar 2025, në dispozicion në https://metamorphosis.org.mk/izdanija_arhiva/procenka-na-nivoto-na-sproveduvanje-na-akciskiot-plan-na-strategijata-za-transparentnost-na-vladata-na-republika-severna-makedonija2023-2026-vo-periodot-januari-2024-januari-2025/

Gjithashtu, rekomandimet e dhëna në këtë dokumenti do të shërbejnë si bazë për aktivitetet e përfaqësimit që në vazhdimësi i ndërmerr Fondacioni “Metamorfozis” me qëllim të avancimit të qeverisjes së mirë të institucioneve. Hulumtimi përsëritet çdo vit dhe na mundëson ta krahasojmë shkallën e veprimit në lidhje me rekomandimet e mëparshme.

2. METODOLOGJIA

Përmes Indeksit të Hapjes bëhet një analizë e thellë të punës së pushtetit ekzekutiv dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por gjithashtu ofron edhe një përmbledhje të performancës së përgjithshme të institucioneve përkatëse në rajonin tonë. Perspektiva rajonale shërben si referencë për atë se si vendet në rajon po përparojnë drejt përmirësimit të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit që i çon ato drejt qëllimit të tyre strategjik - anëtarësimit në BE. **Në këtë dokument janë veçuar vetëm gjetjet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me pushtetin ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Vlerësimi i qeverisjes së mirë është rezultat i një studimi empirik gjithëpërfshirës të bazuar në Indeksin e Hapjes⁷, i cili synon të përcaktojë shkallën në të cilën respektohen parimet e qeverisjes së mirë në vendet në rajon. Implementuar me mbështetjen e Fondit Kombëtar për Demokraci, Fondacionir “Metamorfozis” në Rrjetit për Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore (ACTION SEE)⁸ – për vitin 2024. Vlerësimi i qeverisjes së mirë u krye në katër vende nga Ballkani Perëndimor – Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Vlen të përmendet se edhe pse termi qeverisje e mirë përdoret shpesh në diskursin politik dhe analizën e politikave, ai mbetet një koncept fluid, pa një përcaktim të qartë. Kuptimi i tij, kryesisht, formohet nga qëllimi për të cilin është përdorur dhe komponentët në të cilët përqendrohet. Interpretimi i pranuar gjerësisht është se ky term i referohet një sistemi të qeverisjes që jep rezultate që i plotësojnë nevojat e shoqërisë duke i shfrytëzuar burimet në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ky përkufizim korrespondon me standardet e zbatuara në demokracitë perëndimore liberale, të cilat vendet në zhvillim, siç është Maqedonia e Veriut, i marrin si shembull dhe drejt të cilave shkojnë.

Indeksi i shkallës së hapjes kryhet në përputhje me këtë kornizë parimesh, por , megjithatë , mbetet i vetëdijshëm për zhvillimet kulturore, si dhe për ato historike, në vend dhe në rajon, që ndikojnë edhe në institucionet. Metodologjia e tij garanton se rezultatet e hulumtimit të jenë teknikisht dhe politikisht të vlefshme nga të cilat mund të nxirren përfundime në lidhje me nivelin e qeverisjes së mirë të institucioneve të vendit. Indeksi i Hapjes e vlerëson performancën e autoriteteve në fushën e qeverisjes së mirë duke u përqendruar në katër shtylla: (1) qasshmëria, (2) efikasiteti, (3) integriteti dhe (4) transparenca me një fushë të përbashkët të pranishme në të katër shtyllat– të dhënat e hapura.

⁷ Indeksi i shkallës së hapjes përbëhet nga katër komponentë të ndryshëm– (1) transparenca, (2) qasshmëria, (3) integriteti dhe (4) efikasiteti, dhe secila prej tyre e mat shkallën e hapjes së një dege të ndryshme të qeverisjes: pushteti lokal, pushteti qendror, gjyqësori dhe kuvendi.

⁸ Rrjeti për Përgjegjësi, Teknologji dhe Hapje të Institucioneve në Evropën Juglindore ACTION-SEE paraqet një rrjet të organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku për të promovuar dhe për të siguruar përgjegjësi dhe transparencë të autoriteteve në rajonin e Evropës Juglindore, për ta rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, për t'i promovuar dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në internet dhe për t'i ngritur kapacitetet dhe interesin midis organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në rajon për përdorimin e teknologjisë gjatë punës për përparimin e demokracisë.

Katër shtyllat e Indeksit të shkallës së hapjes e përcaktojnë dhe e vlerësojnë qeverisjen e mirë së bashku me parimet e mëposhtme:

qasshmëria - e vlerëson shkallën në të cilën e drejta për qasje në informata garantohet nga ligji dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për përfshirjen dhe konsultimin gjatë proceseve të hartimit të politikave;

efikasiteti - e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimi – duke përdorur pika/tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit;

transparenca – e vlerëson disponueshmërinë publike të informacionit organizativ, buxhetin dhe procedurat e furnizimeve publike, ndërsa,

integriteti e vlerëson praninë e mekanizmave për të parandaluar konfliktet e interesit, për të rregulluar lobimin, si dhe disponueshmërinë e kodit të sjelljes etike që do ta udhëheqë dhe sanksionojë sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe të administratës publike.

Secila shtyllë e Indeksit përbëhet nga nëndomene dhe tregues të matur sipas vlerës përkatëse brenda shtyllave.

Metodologjia u zhvillua në konsultim me një numër të madhe burimesh të besueshme, duke i theksuar praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare për qeverisje të mirë, të tilla si Banka Botërore, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Udhëzuesi për Qeverinë e Hapur, Raporti Global i Integritetit dhe Treguesit e Qeverisjes dhe Cilësisë Institucionale të zhvilluara nga Banka Botërore.

Hulumtimi i këtij viti u krye në **periudhën nga shkurti deri në maj të vitit 2025**. Mostra e institucioneve të synuara përbëhet nga **gjithsej 40 institucione, duke përfshirë Qeverinë/Sekretariatit e Përgjithshëm, 20 ministri dhe 19 organe ekzekutive të zgjedhura rastësisht në përbërje të ministrive**. Është marrë parasysh edhe organizimi i ri i ministrive në Maqedoninë e Veriut. Metodot e hulumtimit përbëhen nga (1) monitorimi i ueb-faqeve të institucioneve të synuara sipas një sërë treguesish, (2) pyetësi i dorëzuar në institucione për t'i konfirmuar gjetjet e marra nga monitorimi në internet, (3) kërkesa për qasje në informatat me karakter publik dërguar secilit institucion me qëllim që të vlerësohet shkalla e përmbushjes së kësaj të drejte themelore nga secili prej institucioneve, si dhe (4) rishikimi i kornizës legjislative.

Gabimi i matjes është +/- 3%. Në bazë të rezultateve të hulumtimit, ne kemi kryer një analizë të pikave dhe problemeve kyçe kritike në fushën e hapjes së institucioneve, që shpresojmë se do të jenë të dobishme për ta përmirësuar punën e tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se në rastet kur institucionet nuk i kanë dorëzuar pyetësorët e plotësuar, treguesit janë shënuar me 0, , si tregues që nuk janë përmbushur. Në fakt, nga 40 institucione të synuara të pushtetit ekzekutiv, 20 (50%) e plotësuan pyetësorin, ndërsa 50% të tjerat marrin automatikisht 0 sipas treguesve përkatës. Nga institucionet që nuk iu përgjigjën pyetësorit, 10 janë ministri (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme; Ministria e Ekonomisë dhe Punës; Ministria e Transportit; Ministria e Kulturës dhe Turizmit; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Vetëqeverisjes Lokale; Ministria e Marrëdhënieve

Ndërmjet Bashkësive; Ministria e Çështjeve Evropiane; Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale; Ministria e Sportit). Nga 19 organet e monitoruara në përbërje të ministrive, më shumë se gjysma, ose 10, nuk iu përgjigjën pyetësorit (Drejtoria Doganore; Drejtoria për Zbulimin Financiar; Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve; Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale; Inspektorati Shtetëror i Punës; Byroja për Zhvillimin e Arsimit; Komisioni për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare; Byroja për Zhvillimin Rajonal; Inspektorati Shtetëror për Ndërtim dhe Urbanizëm; Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore).

Janë marrë parasysh trendet dhe proceset e reja të digjitalizimit që po ndodhin në botë, e të cilat po bëhen domosdoshmëri edhe në vendin tonë, pritet që në të ardhmen e afërt të ketë një theks gjithnjë e më të madh në transparencën aktive, e cila duhet ta ulë ndjeshëm numrin e kërkesave të parashtruara në letër për qasje të lirë. Për të vlerësuar kohën e pritjes për kërkesat e parashtruara në institucione, **“Metamorfozis”, gjatë monitorimit të hapjes së institucioneve, dërgoi nga një kërkesë për qasje në informata në të gjitha 40 institucionet. Pothuajse 1/4 e institucioneve të monitoruara, gjegjësisht 10, nuk iu përgjigjën fare kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik, nga të cilat 5 ministri dhe 5 organe në përbërje të tyre (Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme; Ministria e Transportit; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Çështjeve Evropiane; Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale; Drejtoria e Zbatimit të Sanksioneve; Inspektorati Shtetëror Administrativ; Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale; Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare; Byroja për Zhvillim Rajonal). Brenda afatit të përcaktuar ligjor, u përgjigjën 21 institucione, ose 52.5%, nga të cilat Sekretariati i Përgjithshëm, 10 organe në përbërje të ministrive dhe 10 ministri.. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar me ligj, u përgjigjën 9 institucione, nga të cilat 5 ministri dhe 4 organe në përbërje të tyre.**

HAPJA E
INSTITUCIONEVE TË
PUSHTETIT EKZEKUTIV NË
RAJON NË VITIN 2024



3. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË RAJON NË VITIN 2024

Hyrje

Modeli i qeverisjes së hapur përfshin një spektër të gjerë politikash dhe praktikash që kontribuojnë për krijimin e një qeverisje më të përgjegjshme, më transparente dhe më efikase. Shikuar nga perspektiva e qeverisë dhe e qytetarëve, qeverisja e hapur ka potencialin për të përmirësuar vendimmarrjen, për të rritur cilësinë e shërbimeve publike dhe për të zvogëluar mundësinë e korrupsionit. Parimet kryesore mbi të cilat bazohet, transparenca, qasshmëria, integriteti dhe efikasiteti, janë baza për ndërtimin e besimit midis institucioneve dhe qytetarëve.

Të udhëhequra nga këto parime, organizatat e shoqërisë civile - Qendra për Tranzicion Demokratik (Mali i Zi), Fondacioni “Metamorfozis” (Maqedonia e Veriut), Partnerët për Ndryshim Demokratik Serbi (Serbi) dhe Shoqata e Qytetarëve “Zashto ne?” (Pse Jo?) (Bosnje dhe Hercegovinë) - e zhvillojnë Indeksin e rajonal të Hapjes, një instrument unik analitik që e monitoron shkallën në të cilën institucionet e pushtetit ekzekutiv në Ballkanin Perëndimor i zbatojnë standardet e qeverisjes së mirë.

Ky është hulumtimi i nëntë me radhë, që e përfshin vitin 2024 dhe gjysmën e parë të vitit 2025, dhe qëllimi i tij mbetet i njëjtë: të ofrojë një analizë të bazuar mirë dhe krahasuese të gjendjes së hapjes dhe transparencës së pushtetit ekzekutiv në rajon dhe të shërbejë si mbështetje për vendimmarrësit në krijimin dhe zbatimin e reformave. Në vitet e mëparshme, rezultatet e këtij hulumtimi shërbenin si nxitje për institucionet që të konkurronin me njëra-tjetrën në hapjen ndaj publikut. Megjithatë, gjetjet e raportit të këtij viti tregojnë se shumë institucione kanë ngecur ose kanë bërë regres, duke treguar se angazhimi deklarativ ndaj vlerave evropiane dhe qeverisjes së hapur shpesh nuk shoqërohet me reforma të vërteta, ndërsa hapja e institucioneve ende varet nga vullneti i mirë i individëve.

Ngjarjet socio-politike të vitit të kaluar, të cilat do të paraqiten më poshtë, konfirmojnë më tej se parimet e hapjes në praktikë po lihen gjithnjë e më shumë mënjanë nga interesat e tjera, më shpesh nga interesi për të mbetur në pushtet. Megjithatë, monitorimi i rregullt dhe metodologjikisht i qëndrueshëm mbetet i rëndësishëm, jo vetëm si një mekanizëm për monitorim, por edhe si një mjet që i mundëson shoqërisë civile, mediave dhe publikut të avokojnë për ndryshime të bazuara në të dhëna të qëndrueshme dhe të krahasueshme.

Duke e respektuar parimin e transparencës, do t'i informojmë institucionet për të gjitha detajet e hulumtimit, të cilat janë gjithashtu të disponueshme publikisht. Mbetemi të hapur për të gjitha propozimet, kritikën me qëllime të mira dhe diskutimet rreth hulumtimit dhe përfundimeve tona.

Hapja e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon - Pasqyrë hyrëse

Në periudhën e kaluar, Bosnja dhe Hercegovina (BdheH), Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë përballur me sfida të ngjashme në aspektin e transparencës qeveritare dhe llogaridhënies institucionale. Sistemet politike të të gjitha këtyre vendeve janë nominalisht demokratike, por në një masë më të madhe ose më të vogël vuajnë nga tendencat "hibride": përqendrim i pushtetit, dobësim i sundimit të ligjit dhe korrupsion i përhapur gjerësisht. Për vite me radhë, "Freedom House" i ka klasifikuar të katër vendet si demokraci "**pjesërisht të lira**", me një trend përkeqësimi të lirive (Serbia, për shembull, ra nga statusi "vend i lirë" në "pjesërisht i lirë" dhe humbi 11 pikë në disa vitet e fundit)⁹. Korniza e përgjithshme rajonale karakterizohet nga një kontekst politik i paqëndrueshëm që ndikon në hapjen e qeverive. **Në disa pjesë të rajonit, gjatë një viti e gjysmë të kaluar, janë vërejtur protesta masive civile dhe kriza të pashembullta politike, të cilat janë si pasojë ashtu edhe shkak i besimit të ulët të publikut në institucione.**

Nga njëra anë, **qytetarët në të gjithë rajonin po kërkojnë gjithnjë e më shumë llogaridhënie nga qeveritë e tyre.**, si përgjigje ndaj skandaleve të korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare ose kërcënimeve ndaj sigurisë publike. Nga ana tjetër, strukturat qeverisëse shpesh kanë reaguar duke kufizuar hapësirën për kritika, qoftë përmes masave formale represive (p.sh., ligjet për shpifje në BdheH, paditë strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut në Serbi) ose presioneve joformale (monitorimi dhe frikësimi i gazetarëve, diskreditimi i OJQ-ve). Megjithatë, janë vërejtur edhe zhvillime pozitive në disa segmente, për shembull, **Maqedonia e Veriut** zbatoi reforma të caktuara digjitale për të përmirësuar transparencën e administratës publike¹⁰, ndërsa **Mali i Zi** mbeti më afër statusit të një "vendi të lirë" sipas "Freedom House" (69/100 pikë, afër pragut për shoqëri "të lirë"), si dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Sipas Indeksit rajonal të Hapjes, rezultatet më të mira midis qeverive në rajon u arritën nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut me përmbushje të treguesve të hapjes prej 77,32% dhe Këshilli i Ministrave i BdheH me 73,72%. Pas tyre vjen Qeveria e Malit të Zi me 67,25% dhe Qeveria e Republikës së Serbisë me 54,74%. Qeveria e Krahinës Autonome të Vojvodinës përmbush 41% të treguesve të hapjes, ndërsa Qeveria e Federatës së BdheH dhe Qeveria e Republikës Serbe së bashku janë në fundin e listës me 35%, ose përmbushje të vetëm rreth një të tretës së treguesve sipas të cilave e matim hapjen.

Kur bëhet fjalë për hapjen e ministrive, rezultatet më të mira mesatarisht u arritën nga ministrinë në Serbi me përmbushje të treguesve të hapjes prej 58,19%, të pasuara nga ministrinë në Maqedoninë e Veriut me 55,91%, Malin e Zi me 49,17% dhe Bosnjë dhe Hercegovinë me 34,4%.

Organet në përbërje të ministrive janë më të hapura në Maqedoninë e Veriut, ku mesatarisht përmbushin 57,79% të kriterëve të hapjes, ndërsa në vendet e tjera përmbushin më pak se gjysmën e kriterëve të përcaktuara të hapjes: Mali i Zi 49,31%, Serbia 42,02% dhe Bosnja dhe Hercegovina 32,38%.

⁹ Portali online "Vreme": "Freedom House: Serbia është vendi i shtatë me rënien më të madhe për sa i përket lirive dhe të drejtave", <https://vreme.com/en/vesti/freedom-haus-srbija-sedma-po-najvecem-padu-sloboda-i-prava/#:~:text=,states>

¹⁰ Skopjeinfo.mk: "Miratohen katër ligjet reformuese të propozuara nga Ministria e Transformimit Digjital", <https://skopjeinfo.mk/usvoeni-chetirite-reformski-zakoni-predlozheni-od-ministerstvoto-za-digitalna-transformacija>

Monitorimi vjetor i institucioneve i kryer përmes Indeksit rajonal të Hapjes shërben si një instrument për dokumentimin dhe krahasimin e progresit të institucioneve brenda kornizës së politikave të hapjes. Edhe pse statistikën nuk mund ta pasqyrojnë plotësisht gjendjen e hapjes së vendeve në rajon, këto rezultate janë indikative dhe tregojnë se hapja është në rënie ose në ngecje në shumicën e institucioneve të monitoruara. Për shembull, megjithëse ministrinë serbe dolën në krye për sa i përket hapjes, kjo nuk ndodhi sepse ministrinë serbe arritën një rezultat dukshëm më të mirë në matjen e fundit, por sepse ministrinë e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut arritën rezultate dukshëm më të këqija krahasuar me vitet e kaluara.

Për ta kuptuar më mirë kontekstin që ndikon në politikat e hapjes, më poshtë është dhënë një përmbledhje e ngjarjeve kryesore politike, ndryshimeve ligjore, praktikave dhe sfidave në fushën e hapjes, të drejtës për qasje në informatat me karakter publik dhe mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile gjatë vitit 2024 dhe gjysmës së parë të vitit 2025.

Ngjarjet politike dhe efektet mbi hapjen institucionale:

Qeveritë në rajon kanë mungesë të plotë të politikave të hapjes dhe mangësi serioze në fushën e sundimit të ligjit.

Bosnja dhe Hercegovina

Në B dhe H, fillimi i vitit 2024 premtoi një moment pozitiv, kur Bashkimi Evropian dha dritën jeshile për hapjen e negociatave për anëtarësim në fund të vitit të kaluar, duke ngjallur optimizëm se integrimi në BE do ta përmirësonte situatën në vend. Megjithatë, kjo perspektivë shpejt ra nën hijen e krizave të rënda të brendshme politike që dominuan pjesën tjetër të vitit 2024 dhe gjysmën e parë të vitit 2025. **B dhe H nuk arriti të përmbushte Agjendën e reformave, duke e lënë atë si partnerin e vetëm të Ballkanit Perëndimor që nuk i përmbushi kushtet për tërheqjen e 70 milionë eurove nga Plani për Rritje i BE-së.** Komisioni Evropian e hodhi poshtë dokumentin e padakorduar dhe vuri në dukje tre probleme kryesore që B dhe H duhet t'i zgjidhë.¹¹

Më 26 shkurt 2025, Gjykata e B dhe H miratoi një aktgjykim të shkallës së parë kundër Presidentit të Republikës Serbe, Millorad Dodik, duke e dënuar atë me një vit burg dhe një ndalim gjashtëvjeçar për të ushtruar funksione publike për shkak të mosrespektimit të vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë.¹² Aktgjykimi shkaktoi një reagim të ashpër nga regjimi i Dodikut: Kuvendi Kombëtar i Republikës Serbe miratoi ligje me të cilat ndalohej funksionimi i gjyqësorit shtetëror në territorin e entitetit (të cilat më vonë u pezulluan përkohësisht nga Gjykata Kushtetuese e B dhe H). Pasi Dodik dhe zyrtarë të tjerë refuzuan të paraqiteshin në seancën dëgjimore lidhur me këto ligje, Gjykata e B dhe H lëshoi urdhër-arreste për ta¹³,

¹¹ Istinomer: "BE-ja dhe B dhe H-ja gjatë vitit 2024: Vit i mundësive të pashfrytëzuara, 2024", <https://istinomjer.ba/eu-i-bih-tokom-2024-godina-neiskoristenih-prilika/>

¹² BBC News në serbisht: Dodik dënohet me një vit burg për mungesë respekti ndaj Përfaqësuesit të Lartë të Bosnjës dhe Hercegovinës", <https://www.bbc.com/serbian/articles/cp8yqq7r374o/lat>

¹³ Istinomer: "Komunikimi jotransparent nga institucionet ka hapur hapësirë për spekulime," <https://istinomjer.ba/netransparentno-komuniciranje-institutija-otvorilo-prostor-za-speculacije/>

gjë që çoi në një nga bllokat më të rrepta institucionale në Bosnjën dhe Hercegovinën pas Dejtonit, me ç'rast Aleanca e Social Demokratëve të Pavarur e paralizoi punën e institucioneve, buxheti i vitit 2025 nuk u miratua, ndërsa reformat që lidhen me integrimin në BE mbetën të bllokuara.

Në rrethana normale, bllokada disamujore e parlamentit dhe pushtetit ekzekutiv do të kishte çuar në rrëzimin e qeverisë, por për shkak të arkitekturës komplekse të Dejtonit, BdheH vazhdoi të funksiononte në ngërç, pa një mekanizëm kushtetues që do t'i detyronte aktorët të bënin kompromis. Analistët kanë paralajmëruar se kjo situatë mund të zgjasë deri në zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2026, gjë që do të thoshte një boshllëk institucional në nivel shtetëror për gati dy vjet.

Pa avancim të transparencës në vendimmarrje

Lidhur me informacionin e disponueshëm mbi mbledhjet qeveritare në BdheH, ky hulumtim nuk regjistron asnjë ndryshim pozitiv. Këtë vit nuk ka ndryshime në praktikën e publikimit të informacionit në lidhje me mbledhjet qeveritare, megjithëse ka dallime në transparencë midis niveleve shtetërore dhe të entiteteve. Ashtu si në vitet e mëparshme, **Këshilli i Ministrave i BdheH tregon një nivel relativisht më të lartë transparence**, duke publikuar në faqen e tij të internetit njoftimet për mbledhjet dhe rendin e ditës, si dhe njoftimet dhe procesverbalet pas mbledhjeve të mbajtura. Megjithatë, transmetimet audio/video ose incizimet e mbledhjeve nuk janë të disponueshme.

Nga ana tjetër, **qeveritë e entiteteve e vazhdojnë trendin negativ të vërejtur në vitet e mëparshme të matjes**. Qeveria e Federatës së BdheH nuk i publikon as procesverbalet e as materialet që do të diskutohen. Në mënyrë të ngjashme, Qeveria e Republikës Serbe nuk ofron qasje në materialet; publiku merr vetëm informacion bazë përmes njoftimeve shtesë. Asnjëra nga qeveritë e entiteteve nuk lejon transmetimin e mbledhjeve ose përfshirjen e publikut në punën e tyre.

Mali i Zi

Mali i Zi përjetoi disa turbulenca politike në vitet 2024 dhe 2025, të cilat ndikuan drejtpërdrejt në transparencën e pushtetit ekzekutiv. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2023, u formua një qeveri e re koalicioni (përbërja e 44-të), e udhëhequr nga kryeministri Milojko Spajić. Qeveria e deklaroi si qëllim kryesor përfundimin e negociatave me BE-në deri në fund të vitit 2026, në mënyrë që vendi të bëhet anëtar i 28-të i BE-së deri në vitin 2028, megjithatë, reformat e zbatuara drejt këtij qëllimi po japin rezultate shumë të kufizuara në praktikë.

Një nga hapat më kontravers të kësaj qeverie ishte nënshkrimi i dy marrëveshjeve ndërqeveritare me Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA) në fillim të vitit 2025, gjë që shkaktoi një reagim të fortë publik që nga dita e parë.¹⁴ Në vend që të krijonte hapësirë për dialog gjithëpërfshirës mbi

Deutsche Welle "Urdhër arresti nga Interpoli për Milorad Dodikun?", <https://www.dw.com/sr/poternica-interpola-za-miloradom-dodikom/a-72039882>

¹⁴ Radio Evropa e Lirë: "Kryeministri i Malit të Zi nënshkruan marrëveshje me Emiratet e Bashkuara Arabe", <https://www.slobodnaevropa.org/a/premier-crne-gore-potpisao-sporazume-sa-ujedinjenim-arapskim-emiratima-/33363297.html>

OJQ MANS: "Marrëveshja me Emiratet mundëson anashkalimin e ligjeve të shpronësimit dhe kufizimeve mbi të drejtat e pronës: PËR PROJEKTET ARABE, DO TË KONFISKOHEN PRONA PA VENDIM GJYKATE", <https://www.mans.co.me/sporazum-sa->

projektet e zhvillimit afatgjatë, i gjithë procesi, nga nënshkrimi deri te miratimi në Parlament, u shënuar me mungesë të transparencës, mungesë të debatit publik dhe polemika të shumta. Marrëveshja për Bashkëpunim në Fushën e Turizmit dhe Zhvillimit të Pasurive të Patundshme tërhoqi vëmendje të veçantë¹⁵, dispozitat e së cilës u vlerësuan si problematike nga pikëpamja e standardeve demokratike dhe sundimit të ligjit. **Konkretisht, marrëveshja parashikonte drejtpërdrejt se të gjitha kontratat dhe marrëveshjet shitesë me investitorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe do të përjashtoheshin nga rregullat për furnizimet publike, tenderët dhe konkurrenca.** Me fjalë të tjera, një investitori të huaj do t'i jepet një pozicion i privilegjuar dhe mundësi për të zbatuar megaprojekte jashtë procedurave të zakonshme dhe të mbikëqyrjes publike.

Organizatat joqeveritare, aktivistët dhe qytetarët vunë në dukje aspektet e dëmshme të kësaj marrëveshjeje, duke këmbëngulur për transparencë, llogaridhënie dhe mbrojtje të interesit publik. Mesazhet që Mali i Zi mori nga BE-ja tregonin se marrëveshja mund të rrezikonte potencialisht procesin e integritetit evropian të Malit të Zi. Megjithatë, shumica në Parlament votuan për këtë ligj.

Mbledhjet telefonike qeveritare e zvogëlojnë dukshmërinë e procesit të vendimmarrjes

Një nga trendet shqetësuese në praktikën e kësaj qeverie malazeze është shmangia e procedurave standarde të vendimmarrjes. **Qeveria e Malit të Zi ka një praktikë të mbajtjes së mbledhjeve "me telefon" që e tejkalon shumë numrin e mbledhjeve të rregullta.** Gjatë vitit 2024, më shumë se gjysma e mbledhjeve qeveritare u mbajtën nëpërmjet procedurave telefonike/online, ndërsa në gjashtë muajt e parë të vitit 2025, kjo përqindje u rrit në dy të tretat e të gjitha mbledhjeve. **Në praktikë, kjo do të thotë se ministrat deklarohen përmes grupeve në WhatsApp, duke i konfirmuar zyrtarisht vendimet pa u takuar fizikisht dhe pa debatuar.** Kjo mënyrë e punës e bën diskutimin kolegial të pakuptimtë dhe e zvogëlon dukshmërinë e procesit të vendimmarrjes, ndërsa deklaratat nga këto mbledhje nuk janë mjaftueshëm të detajuara. Për më tepër, disa nga vendimet dhe politikat më të rëndësishme janë marrë në këtë mënyrë, gjë që nënkupton shmangien e vetëdijshme të publikut dhe mediave: mbledhjet telefonike, nëse është e nevojshme, mund të thirren shpejt dhe në çdo kohë dhe pa asnjë kontroll nga publiku.

Maqedonia e Veriut

Vitin e kaluar, Maqedonia e Veriut përjetoi ndryshime të rëndësishme politike, të cilat ndikuan edhe në hapjen e qeverisë. Në zgjedhjet e majit të vitit 2024, partia e krahut të djathtë në opozitë, VMRO-DPMNE-ja, kori fitore dhe fitoi shumicën në parlament. Në të njëjtën kohë, kandidatja e partisë, Gordana Siljanovska-Davkova, fitoi në zgjedhjet presidenciale.

Fundi i vitit 2024 u shënuar gjithashtu nga një **skandal serioz antikorrupsion** brenda vetë qeverisë. Në dhjetor të vitit 2024, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një urdhër arresti për ish-

[emiratima-omogucava-zaobilazjenje-zakona-o-eksproprijaciji-i-ogranicenje-prava-svojine-za-projekte-arapa-oduzimace-imovinu-bez-sudske-odluke/](https://www.gov.me/dokumenta/c8703743-e81b-43b7-9278-ab61d640eed3)

¹⁵ Qeveria e Malit të Zi, Propozimi i Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim në Fushën e Turizmit dhe Zhvillimit të Pasurive të Patundshme midis Qeverisë së Malit të Zi dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe:

<https://www.gov.me/dokumenta/c8703743-e81b-43b7-9278-ab61d640eed3>

zëvendëskryeministrin Artan Grubi (nga qeveria e mëparshme), i cili akuzohet për përvetësim të afërsisht 8 milionë eurove përmes lotarisë shtetërore.¹⁶ Grubi u largua menjëherë nga vendi, gjë që shkaktoi zemërim publik dhe akuza se kishte marrë informacion se do të arrestohej. Ky rast e rriti **fokusin e publikut ndaj korrupsionit të nivelit të lartë** dhe e ngriti pyetjen nëse qeveria e re do t'i ndjekë penalisht ish-funksionarët?

Ngjarja më tragjike në Maqedoninë e Veriut gjatë kësaj periudhe ndodhi më 16 mars 2025, kur një zjarr përfshiu një klub nate të mbushur me njerëz në qytetin e Koçanit gjatë një koncerti nga grupi hip-hop "DNK". **Në zjarr e humbën jetën 62 persona dhe u lënduan mbi 150 të tjerë.**¹⁷ Kjo fatkeqësi u bë menjëherë një tragjedi kombëtare dhe shkaktoi një valë protestash në të gjithë vendin. Qytetarët u indinjuan kur dolën në dritë prova se klubi nuk kishte lejet e duhura për zjarrfikje dhe se inspektimet i kishin mbuluar parregullsitë. Mbledhje përkujtimore u mbajtën në Shkup, Shtip, Manastir dhe qytete të tjera për të nderuar viktimat, si dhe protesta ku kërkohej përgjegjësi nga të gjithë ata që ishin përgjegjës në zinxhir (nga pronari i klubit e deri te shërbimet e inspektimit).¹⁸ Funeralet e viktimave u shndërruan në demonstrim të mosbindjes qytetare. Autoritetet u përpoqën ta qetësonin situatën me një sërë premtimesh, por protestat zgjatën me javë të tëra, duke demonstruar pakënaqësinë e thellë të popullsisë nga sistemi që nuk arrin ta mbrojë sigurinë themelore.

Në prill të vitit 2025, shpërtheu një tjetër skandal në luftën kundër korrupsionit, **këtë herë brenda vetë organit antikorruption**. Më 25 prill 2025, Prokuroria ia sekuestroi përkohësisht pasaportën Tatjana Dimitrovskës, kryetares së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, dhe ia ndaloi asaj të kryente detyrat e saj, për shkak të dyshimit për rrjedhje të informacionit konfidencial tek të dyshuarit në një rast të madh korrupsioni. Rasti përfshin rreth 30 persona të akuzuar për keqpërdorimin e furnizimeve publike të aditivëve për termocentralet shtetërore.¹⁹

Nuk ka përparim në transparencën proaktive të qeverisë

Kur bëhet fjalë për hapjen e vetë pushtetit ekzekutiv në procesin e vendimmarrjes, situata në Maqedoninë e Veriut nuk ka ndryshuar ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara. Mbledhjet e qeverisë nuk janë të hapura për publikun dhe nuk transmetohen. Qeveria herë pas here ka publikuar të ashtuquajturat përmbledhje të vendimeve pas mbledhjeve, por kjo nuk është e mjaftueshme për të ofruar informacion për mënyrën se si merren vendimet. Megjithatë flitet shumë për termin "transparencë proaktive", qytetarët ende nuk kanë qasje sistematike në atë se çfarë do të bëjë Qeveria përpara se të miratohen vendimet.

¹⁶ Balkan Insight: "Maqedonia e Veriut kërkon ish-zëvendëskryeministrin në arrati për akuza për përvetësim" <https://balkaninsight.com/2024/12/18/north-macedonia-seeks-fugitive-ex-deputy-pm-over-embezzlement-allegations/>

¹⁷ Radio Evropa e Lirë: "Të paktën 59 persona humbën jetën në zjarrin në një klub nate në Maqedoninë e Veriut." <https://www.slobodnaevropa.org/a/pozar-kocani-sjeverna-makedonija/33349438.html>

¹⁸ The Guardian: "Vajtesit protestojnë kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut pas zjarrit në një klub nate" <https://www.theguardian.com/world/2025/mar/17/mourners-protest-against-corruption-in-north-macedonia-after-nightclub-fire>

¹⁹ "Sloboden Peçat": "PTHP-ja: Kryetarja e Komisionit Antikorruption i zbuloi sekrete zyrtare një të pandehuri në rastin "Aditiv" <https://www.slobodenpecat.mk/en/ojo-pretседателката-na-antikorupciska-mu-odavala-sluzhbeni-tajni-na-obvinet-vo-aditiv/>

Serbia

Periodha nga fundi i vitit 2024 deri në kohën e shkrimit të këtij raporti u shënua nga **protesta masive civile** gjë që e tronditi monopolin e pushtetit të Partisë Progresive Serbe (SNS) dhe Presidentit Aleksandar Vuçiç. Arsyeja për këtë ishte **aksidenti tragjik i 1 nëntorit 2024, kur një tendë u shemb në stacionin hekurudhor të Novi Sadit, duke vrarë 16 persona**. Kjo ngjarje shkaktoi pakënaqësi publike dhe çoi në demonstratat më të mëdha në Serbi në dekadat e fundit. Studentët filluan bllokadë të orëve të mësimi në universitet në dhjetor të vitit 2024, duke kërkuar transparencë dhe përgjegjësi për aksidentin; protestat shpejt u përhapën edhe në grupe të tjera shoqërore (mësues, fermerë, punëtorë, avokatë) dhe në qytete në të gjithë vendin²⁰. Protestuesit e akuzojnë hapur qeverinë për korrupsion dhe paaftësi që, sipas mendimit të tyre, çuan në katastrofë, duke theksuar se prishja e stacionit të rinovuar është një simbol i problemeve më të gjera sistemor.²¹ Regjimi i Vuçiçit iu përgjigj këtyre presioneve me një përzjerje lëshimesh të kufizuara dhe represioni, u njoftuan disa masa antikorrupsion, kryeministri dha dorëheqje dhe qeveria u ristrukturua, por në të njëjtën kohë, për çdo ditë regjistrohen raste të brutalitetit policor, arrestimit, përgjimit dhe frikësimit të pjesëmarrësve në protesta dhe aktivistëve.²² Serioziteti i presionit mbi liritë civile ilustron edhe me faktin se gjatë protestës së madhe në mars të vitit 2025, dyshohet se u përdor një pajisje sonike për të shpërndarë protestat. Në këtë drejtim, në mars të vitit 2025, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkoi shpjegime nga Serbia dhe lëshoi një masë që i kërkonte shtetit të “parandalonte përdorimin e armëve sonike ose pajisjeve të ngjashme” kundër qytetarëve.²³ Fenomene të tilla, dikur të paimagjinueshme, tregojnë një tendencë të forcimit të metodave autoritare. Edhe pse në mënyrë deklarative nuk devijojnë nga demokracia, në praktikë qeveria serbe po tregon gjithnjë e më shumë intolerancë ndaj kritikave, lirisë së shprehjes dhe lirisë së tubimit.

Vendimmarrje jotransparente nga institucionet kompetente

Në Serbi, proceset e vendimmarrjes qeveritare ende janë të mbuluara nga sekretet. Për të dytin vit radhazi, qeveria nuk ka publikuar një plan pune (plani i fundit i disponueshëm për publikun ishte për vitin 2023), dhe as nuk ka raportuar rregullisht për punën e saj. Plani i Veprimit për zbatimin e programit

²⁰ Portali “Zëri i Amerikës”: “Mbaron protesta studentore, numër i madh njerëzish në rrugët e Beogradit, u vunë re disa incidente”, <https://www.glasamerike.net/a/beograd-protest-15-mart-mir-studenti-blokada-vu%C4%8Di%C4%87/8011520.html>
Al Jazeera: “Protestat i kanë përfshirë të gjitha shtresat e shoqërisë dhe të Serbisë”

<https://balkans.aljazeera.net/news/balkan/liveblog/2025/1/28/tuzilastvo-traga-za-napadacima-na-studente-u-novom-sadu>

²¹ Portali online Insajder: “Rënia e tavanit, shembje e sistemit”: <https://www.insajder.net/teme/padovi-plafona-pad-sistema-gradevinska-inzenjerka-o-losim-rekonstrukcijama-u-srbiji-video>

²² “Nova S”: “Arrestohet aktivisti që bënte thirrje për protesta për shkak të tragjedisë në Novi Sad”,

<https://nova.rs/vesti/drustvo/uhapsen-aktivista-koji-je-pozvao-na-protest-zbod-tragedije-u-novom-sadu/>

Radar: “Mos dil në protestë, do të të arrestojnë” <https://radar.nova.rs/drustvo/bia-prati-i-poziva-studente-na-saslanja/>

Radio Evropa e Lirë: “Publikimi i të dhënave personale të disa studentëve në bllokada si kërcënim për sigurinë”,

<https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-studenti-u-blokadi-objavlivanje-podataka-bezbednost/33262533.html>

Radio Evropa e Lirë: “77 persona të arrestuar pas protestës në Beograd, Vuçiç njofton arrestime të reja”

<https://www.slobodnaevropa.org/a/vucic-dacic-protest-beograd-slavija/33458361.html>

Koha: “I rrahur, i operuar dhe i akuzuar: Studenti Luka Mihajlović mbetet në arrest shtëpiak”

<https://vreme.com/vesti/pretucen-operisan-i-optuzen-student-luka-mihajlovic-i-dalje-u-kucnom-privotu/>

²³ AP: “Gjykata Evropiane urdhëron Serbinë të ‘parandalojë përdorimin e armëve sonike’ pas pretendimeve nga protestuesit në tubim” <https://apnews.com/article/serbia-sonic-weapon-human-rights-court-30de60760590703a457a896239e886e9>

qeveritar 2023-2026 është i disponueshëm publikisht,²⁴ por nuk është përditësuar e as nuk janë publikuar raporte për zbatimin e tij. Metoda e planifikimit, e më pas edhe e vendimmarrjes është plotësisht jotransparente. Publiku mund të mësojë rreth pjesëve të planeve, angazhimeve dhe raportimit mbi aktivitetet e planifikuara nga dokumentet strategjike të krijuara në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE, thjesht sepse Serbia është e detyruar të raportojë për këtë në institucionet evropiane.

Nuk ka transmetim të mbledhjeve qeveritare e as qasje të drejtpërdrejtë në diskutime. **Përshtypja e përgjithshme është se vendimet kryesore nuk merren në mbledhjet e qeverisë, por në një rreth të ngushtë rreth presidentit të shtetit.** Edhe pse formalisht presidenti i shtetit nuk ka kompetenca sipas Kushtetutës, ai de facto e dikton drejtimin e qeverisë, gjë që është e dukshme edhe në praktikën e përditshme: në televizion, presidenti publikon rregullisht vendimet se cilat projekte do të financohen nga buxheti, cilat fshatra do të kenë rrugë të reja ose sa ndihmë do t'u ndahet qytetarëve pas një katastrofe. Një vendimmarrje e tillë e personalizuar jashtë institucioneve i minon parimet e përgjegjësisë dhe ndarjes së pushteteve.

Iniciativa të rëndësishme legislative për politikat e hapjes në rajon

Në **Bosnjë dhe Hercegovinë** në vitin 2023, më në fund u miratua **Ligji i ri për Lirinë e Qasjes në Informacionin në Nivel Shtetëror**. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji nuk ka treguar efekte pozitive, por ka kontribuar në vështirësimin e ushtrimit të kësaj të drejte. "Transparency International" në BdheH kreu një analizë të zbatimit të Ligjit²⁵ dhe zbuloi se ligji i ri nuk e ka përshpejtuar procesin e marrjes së informacionit; përkundrazi, në disa raste, informacioni kyç tani kërkohet edhe më gjatë se më parë. Autoritetet shpesh i përdorin përjashtimet e shumta të parashikuara me ligj për ta mbajtur informacionin e kërkuar.²⁶

Gjithashtu u vu re se Distrikti i Bërçkos, pas miratimit të ligjit shtetëror, u përjashtua prej tij dhe e filloi procesin e përgatitjes së ligjit të vet. Kuvendi i Bërçkos e miratoi propozim-ligjin në maj të vitit 2025, por ai menjëherë u përball me kritika sepse parashikon **heqjen e të drejtës së ankimit**; në vend të një procedure ankimi para një organi të pavarur shtetëror, kërkesit e pakënaqur të informacionit do të duhet të fillojnë procedurë gjyqësore, gjë që në praktikë do të thotë kosto më të larta dhe ushtrim më të ngadaltë të të drejtave. Si justifikim, autoritetet e Bërçkos deklaruan se distrikti nuk ka një institucion të pavarur që do të mund të zgjidhte apelin e shkallës së dytë. Ky rast e nxjerr në pah problemin e fragmentimit të kornizës ligjore në BdheH: nivelet e ndryshme të pushtetit (shteti, entitetet, distrikti) shpesh kanë rregulla të ndryshme, gjë që krijon konfuzion dhe qasje të pabarabartë në të drejtat e qytetarëve.

Në Republikën Serbe, përkundrazi, nuk ka zhvillime pozitive ligjore që do ta përmirësonin transparencën. Nga fundi i vitit 2023, **autoritetet e Republikës Serbe** përsëri e kriminalizuan shpifjen,

²⁴ Qeveria e Serbisë: "Plani i Veprimit për zbatimin e Programit të Qeverisë 2023-2026" të Serbisë"

<https://www.gs.gov.rs/tekst/470/akcioni-plan-za-sprovodjenje-programa-vlade-2023-2026.php>

²⁵ "Transparency International" BdheH, Analizë: "Ligjet reformuese të miratuara si pjesë e integritetit në BE nuk kanë dhënë rezultate, në disa fusha ka efekte negative të dukshme"" https://ti-bih.org/wp-content/uploads/2024/07/Press-rls_22.07.24.pdf

²⁶ Po aty

duke futur dënime drakoniane për "fyerje" dhe "bërje pretendimesh të rreme" në media. Në shkurt të vitit 2025, Kuvendi Kombëtar i Republikës Serbe e miratoi dhe **Ligjin për Regjistrat e Posaçëm dhe Transparencën e Punës së Organizatave Jofitimprurëse**, i quajtur në gjuhën e folur "Ligji për Agjentët e Huaj". Ky ligj i detyron organizatat joqeveritare që marrin fonde nga jashtë të regjistrohen si "agjentë të huaj" dhe përcakton kontroll të rreptë mbi punën e tyre. Këto masa kanë alarmuar bashkësinë ndërkombëtare dhe aktivistët vendas, duke pasur parasysh se efektet e këtyre ligjeve mund të çojnë shpejt në një rritje të autocensurës. Në maj të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës e anuloi "Ligjin për Agjentët e Huaj"²⁷, duke e kthyer topin në fushën e entitetit të Republikës Serbe, i cili tashmë ka refuzuar të zbatojë vendimet e gjykatave shtetërore.

Në periudhën e kaluar, nuk ka pasur nisma të rëndësishme legislative që do të ndikonin në politikën e hapjes në **Malin e Zi**. E drejta për qasje të lirë në informacion u degradua ndjeshëm nga ndryshimet në ligj në vitin 2017, kur u futën përjashtime të gjera si "sekretet afariste" dhe "sekretet tatimore". Këto dispozita u lejuan autoriteteve të kufizonin më lehtë qasjen në informacion, gjë që është në kundërshtim me frymën themelore të ligjit. Rezultati ishte ngushtim i hapësirës për mbikëqyrje nga qytetarët mbi fushat e ndjeshme ndaj korrupsionit. Ndërgjegjësimi për këtë dhe probleme të tjera në këtë fushë ka çuar në një sërë përpjekjesh për të miratuar një Ligj krejtësisht të ri për Qasjen e Lirë në Informacion: në katër vitet e fundit, propozimet janë tërhequr nga procedura parlamentare tri herë.

Më në fund, në fillim të vitit 2025, Qeveria e re miratoi një Propozim-ligj të ri për Qasjen e Lirë në Informacion.²⁸ dhe e dërgoi atë në Parlament, duke kërkuar miratim të menjëhershëm. Propozimi u përfshi në rendin e ditës së seancës plenare në prill të vitit 2025, por ende nuk është miratuar. Ky ligj kyç për të forcuar përgjegjësinë institucionale dhe për të luftuar korrupsionin ka mbetur në plan të dytë sepse, megjithëse pritej, deputetët ende nuk e kanë votuar atë.

Qeveria e mëparshme e **Maqedonisë së Veriut** e miratoi **Strategjinë për Transparencë të Qeverisë 2023–2026** me një Plan Veprimi shoqërues, i cili ka qëllime ambicioze për promovimin e hapjes së institucioneve. Megjithatë, zbatimi i Strategjisë ka ngecur, domethënë, nga të gjitha aktivitetet e planifikuara, vetëm një është zbatuar plotësisht në vitin e parë.²⁹ Për më tepër, vetë procesi i zbatimit të Strategjisë nuk është transparent, pasi nuk ka informacion zyrtar në dispozicion mbi shkallën e zbatimit të masave të tjera, si dhe nëse Qeveria e re mbetet e përkushtuar ndaj këtyre qëllimeve.

Maqedonia e Veriut vazhdoi me aktivitetet legislative në fushën e transformimit digjital të administratës publike, në përputhje me Agjendën e reformës dhe standardet evropiane. Në gjysmën e parë të vitit 2025, u miratua një grup prej katër ligjesh (mbi sigurinë kibernetike, komunikimet elektronike, identitetin digjital dhe arkivimin digjital), të cilat synojnë modernizimin e administratës, rritjen e

²⁷ Gjykata Kushtetuese e BdeH, mbledhje e 158-të plenare: <https://www.ustavisud.ba/bs/158-plenarna-sjednica-dosadasnji-tok-zasjedanja>

Shtëpia e të Drejtave të Njeriut: Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës anuloi Ligjin për Regjistër të Posaçëm dhe Transparencën e Punës së Organizatave Jofitimprurëse të Republikës Serbe. <https://kucaljudskihprava.org/ustavni-sud-bih-stavio-van-snage-zakon-o-posebnom-registru-i-javnosti-rada-neprofitnih-organizacija-rs/>

²⁸ Propozim-ligji për Qasje të Lirë në Informata: <https://wapi.gov.me/download-preview/f3770721-0316-42eb-91de-2d4d8ce9f3b9?version=1.0>

²⁹ Fondacioni Metamorfozis: "Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV-së (2023-2025), për periudhën janar 2024-janar 2025" https://metamorphosis.org.mk/izdanija_arhiva/procenka-na-nivoto-na-sproveduvanje-na-akciskiot-plan-na-strategijata-za-transparentnost-na-vladata-na-republika-severna-makedonija2023-2026-vo-periodot-januari-2024-januari-2025/

transparencës proaktive dhe lehtësimin e qasjes në shërbime. BE-ja e mirëpriti këtë përparim dhe miratoi më shumë se 19 milionë euro për zbatimin e reformave.

Gjatë periudhës së vëzhguar, **Serbia** ka mbetur pa përparim të ndjeshëm në politikat që ndikojnë në përmirësimin e hapjes. Gjatë vitit 2024, u ngrit një iniciativë për **Ndryshimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik** me qëllim të zgjidhjes së problemit shumëvjeçar të abuzimit me ligjin, i cili çoi në ngecje në punën e Komisionerit për mbrojtjen e kësaj të drejte dhe e vështirësoi ushtrimin e të drejtave, veçanërisht të drejtën e ankimit.³⁰ Sektori civil mori pjesë aktive në konsultimet publike, duke dërguar propozime dhe komente, duke pasur parasysh se kërkesa që sektori civil dhe mediat të jenë pjesë e grupit të punës për ndryshimin e ligjit nuk u pranua.

Ndryshimet e propozuara u kritikuan sepse nuk i adresojnë problemet kryesore në praktikë, siç janë moszbatimi i shpeshtë i vendimeve të Komisionerit nga ana e autoriteteve, mungesa e mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e ligjit dhe qasja e vështirë në informacion mbi punën e organeve publike mbi të cilat Komisioneri nuk ka juridiksion në procedurën e ankimit (Qeveria, Presidenti, Kuvendi Kombëtar, Gjykata Supreme, Gjykata Kushtetuese, Banka Kombëtare e Serbisë dhe Prokurori Publik Shtetëror).³¹ Gjatë debatit publik, organizatat e shoqërisë civile parashtruan edhe propozime alternative për të përmirësuar tekstin e ligjit, nga të cilat u refuzuan të gjitha.³² Pas konsultimeve publike dhe një procesi të debatit publik, më 13 shkurt 2025, Qeveria në largim miratoi Propozim-ligjin për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.

Pas kritikave nga shoqëria civile³³, e cila e konsideroi të gjithë procesin të karakterizuar nga mungesa e transparencës dhe pjesëmarrja e pamjaftueshme e të gjithë palëve të interesuara përkatëse, ndërsa për shkak të krizës politike që zgjati disa muaj, ligji i propozuar u tërhoq nga procedura parlamentare në fillim të marsit të vitit 2025.

Veprimi në lidhje me kërkesat për qasje të lirë në informatat me karakter publik në rajon

Në kuadër të Indeksit rajonal të Hapjes, organizatat e shoqërisë civile çdo vit parashtrojnë kërkesa të ngjashme për qasje të lirë në informatat me karakter publik në rajon tek autoritetet e vendeve që monitorohen. Në vitin 2024, tema e kërkesave ishte informacioni mbi rrogat, kompensimet dhe llojet e tjera të pagesave për punonjësit dhe zyrtarët në institucione.

Tabela më poshtë i tregon rezultatet.

Tabela 1: Veprimi në lidhje me kërkesat për qasje të lirë në informatat me karakter publik

³⁰ Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale: "Ndryshohet Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik" <https://mduls.gov.rs/saopstenja/menja-se-zakon-o-slobodnom-pristupu-informacijama-od-javnog-znacaja/?script=lat>

³¹ Partnerët Serbi: "Deklaratë e Koalicionit për Lirinë e Qasjes në Informacion dhe Konventës Kombëtare për Bashkimin Evropian: Ndryshimet e propozuara në Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik e zvogëlojnë nivelin e arritur të të drejtave dhe hapin hapësirë për keqpërdorime të mëtejshme" <https://www.partners-serbia.org/post?id=629>

³² Propozimet e organizatës "Partnerët Serbi", të zhvilluara në bashkëpunim me anëtarët e Koalicionit për Lirinë e Qasjes në Informacion, janë të disponueshme në faqen e internetit të organizatës "Partnerët Serbi": https://www.partners-serbia.org/public/news/Obrazac_za_predloge-Nacrt_ZoSPIJZ_Koalicija_za_slobodu_pristupa_informacijama.pdf

³³ Partnerët Serbi "Iniciativë drejtuar Qeverisë së Serbisë dhe Kuvendit Kombëtar për të pezulluar procesin e miratimit të ndryshimeve në Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik" <https://www.partners-serbia.org/post?id=642>

Shteti	Institucioni	Numri total i kërkesave	Përgjigja brenda afatit ligjor	Përgjigja jashtë afatit ligjor	Kërkesat e refuzuara	Nuk ka përgjigje (heshtje nga administrata)
BdheH	ministrinë	41	22 (53,7%)	0	0	19 (46,3%)
	organet në përbërje të ministrive	55	30 (54,5%)	0	0	25 (45,5%)
	qeverinë	3	1 (33,3%)	0	0	2 (66,7%)
Mali i Zi	ministrinë	25	6	18	3	1
	organet në përbërje të ministrive	13	9 (69,2%)	4 (30,8%)	0	0
	Qeveria	1	0	1 (100,0%)	0	0
Maqedonia e Veriut	ministrinë	20	10 (50,0%)	5 (25,0%)	0	5 (25,0%)
	organet në përbërje të ministrive	19	10 (52,6%)	4 (21,1%)	0	5 (26,3%)
	Qeveria	1	1 (100,0%)	0	0	0
Serbia	ministrinë	25	18 (72,0%)	4 (16,0%)	1 (4,0%)	3 (12,0%)
	organet në përbërje të ministrive	30	28 (93,33%)	0	1 (3,3%)	2 (6,67%)
	qeverinë	2	2 (100,0%)	0	0	0

Rezultatet tregojnë dallime të konsiderueshme midis vendeve dhe niveleve të pushtetit ekzekutiv. **Në Serbi** u vu re një nivel relativisht i lartë efikasiteti, një përqindje e madhe e organeve në përbërje të ministrive (93%) dhe pak më shumë se gjysma e ministrive (72%) u përgjigjën brenda afatit ligjor, ndërsa mungesë përgjigjeje (heshtje e administratës) u vu re vetëm në pesë raste nga gjithsej 57 kërkesa. Kjo mund të jetë një pasojë pozitive e ndryshimeve në Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik të vitit 2021, kur u prezantua një masë për të lëshuar urdhëra për kundërvajtje në situata kur institucionet heshtin, gjegjësisht nuk u përgjigjen fare kërkesave për qasje në informata. Një trend pozitiv në uljen e heshtjes administrative në Serbi mund të shihet edhe në raportet vjetore të Komisionerit për Informata me Karakter publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.³⁴ Serbia dhe Mali i Zi, ndryshe nga dy vendet e tjera të monitoruara, patën gjithashtu raste të refuzimit për të dhënë informacionin e kërkuar. **Në Maqedoninë e Veriut**, rreth gjysma e kërkesave u zgjidhën brenda afatit të caktuar, ndërsa 25% e përgjigjeve mbërritën me vonesë, dhe në 25% të rasteve institucionet nuk u përgjigjën fare. Kur bëhet fjalë për **Malin e Zi**, madje 72% e ministrive dërguan përgjigje jashtë afatit ligjor, shpesh pas kërkesave të shumëfishta, e disa përgjigje mbërritën pothuajse dy muaj më vonë. **Bosnja dhe Hercegovina** ka

³⁴ Komisioneri për Informata me Karakter Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Raporti vjetor i punës për vitin 2024, në dispozicion në linkun e mëposhtëm: https://www.poverenik.rs/images/stories/dokumentacija-nova/izvestajiPoverenika/2024/LATGodi%C5%A1nji_izve%C5%A1taj_2024_002.pdf

përqindjen më të lartë të heshtjes administrative, me ç'rast ministritë dhe organet administrative nuk kanë marrë përgjigje në më shumë se 45% të kërkesave.

Rezultatet e paraqitura në këtë pjesë tregojnë nevojën për përpjekje shtesë për të përmirësuar praktikat institucionale në përpunimin e kërkesave, me një fokus të veçantë në respektimin e afateve dhe reduktimin e heshtjes administrative, gjë që e dëmton drejtpërdrejt të drejtën e qytetarëve për informacione.

Institucionet dhe shoqëria civile: Bashkëpunim formal me presione në rritje

Hulumtimi e analizoi bashkëpunimin e autoriteteve ekzekutive me sektorin e shoqërisë civile duke kërkuar përmbajtje në faqet zyrtare të internetit dhe duke dërguar pyetësorë te institucionet. Nga gjithsej 273 institucione në mostër, u përgjigjën 77 (rreth 32%). Duke qenë se pyetësorët plotësohen vullnetarisht, vetë akti i përgjigjes është një tregues i hapjes institucionale dhe gatishmërisë për të bashkëpunuar me shoqërinë civile.

Edhe pse ekziston bashkëpunim deklarativ me sektorin e shoqërisë civile, siç mund të shihet nga dokumentet strategjike dhe kërkimet në faqet e internetit të institucioneve, raste të shumta tregojnë se ka përkeqësim të mjedisit të punës për organizatat e shoqërisë civile, mediat e pavarura dhe aktivistët. Në Serbi, në fillim të vitit 2025, u regjistrua një bastisje policore në ambientet e pesë organizatave të shoqërisë civile, ndërsa raporti i "Amnesty International"³⁵ tregon se përdoren programe spiunimi kundër gazetarëve dhe aktivistëve. Në Maqedoninë e Veriut, pasi studentët e fishkëlluan ministren e arsimit gjatë një përkujtimi të zjarrit në diskotekën e Koçanit, gazetari që i shpërndau pamjet filmike u bë shënjestër e një fushate të koordinuar online me shpifje dhe kërcënime me vdekje, pa asnjë reagim institucional.³⁶ Në Republikën Serbe, kriminalizimi i shpifjes shkaktoi protesta të mediave dhe frikë të arsyeshme. Në Mal të Zi, miratimi i Ligjit për Agjentët e Ndikimit të Huaj u paralajmërua në fund të vitit të kaluar.³⁷ Edhe pse aktivitetet për përgatitjen e tij nuk kanë filluar, nismëtarët nuk e kanë braktisur zyrtarisht kurrë idenë, ndërsa në disa media të afërta me qeverinë, fushata kundër sektorit të shoqërisë civile vazhdon.

³⁵ "Amnesty International": "Serbi: Autoritetet përdorin mjete spiunazhi dhe forenzike nga Cellebrite për të hakuar gazetat dhe aktivistët. <https://securitylab.amnesty.org/latest/2024/12/srbija-vlasti-koriste-spijunske-softvere-i-forenzicke-alate-kompanije-cellebrite-za-hakovanje-novinara-i-aktivista/>

³⁶ Meta.mk: "Dorëheqje në heshtje" <https://meta.mk/sq/resignations-in-silence/>

³⁷ Radio Evropa e Lirë: "Duke ndjekur shembullin e Rusisë, një pjesë e qeverisë në Mal të Zi paralajmëron një ligj për agjentët e huaj": <https://www.slobodnaevropa.org/a/vlada-crna-gora-zakon-strani-agenti/33153904.html>

HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË VITIN 2024



4. HAPJA E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË VITIN 2024

4.1 PËRMBLEDHJE PËR PUSHTETIN EKZEKTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Rezultati i përgjithshëm i pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut (qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) sipas Indeksit të Hapjes, në vitin 2024 pati një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2023, gjegjësisht arrin **63,71% përmbushje të treguesve të hapjes (krahasuar me vitin 2023 kur arriti 67%)**.

Hapja sipas grupeve të institucioneve



77,32%
Qeveria e
Maqedonisë
së Veriut



57,59%
Organet ekzekutive



56,02%
Ministritë

Krahasuar midis grupeve të institucioneve (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive), **më e hapura është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila përmbush 77,32% të kriterëve të përcaktuara për hapje**. Për herë të parë që kur matet hapja e institucioneve, në vendin e dytë janë organet ekzekutive me 57,79%, ndërsa me rezultatin më të ulët sipas Indeksit, gjegjësisht me përmbushje të treguesve prej 56,02%, janë ministritë (të cilat kanë një rënie prej 8% të treguesve të hapjes krahasuar me vitin e kaluar).

Këtë vit është vënë re se në të gjitha ministritë, përveç në tre prej tyre (Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministrinë për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive) ka një rënie të konsiderueshme të treguesve të hapjes. Rënie më të madhe të treguesve të hapjes ka Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme.

Analizuar nga **aspekti rajonal** (Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina), **përmbushja mesatarja e treguesve të qeverive të të cilave është 60,17 %**, rezultati i qeverisë së Maqedonisë së Veriut është shumë i mirë, sepse për gjashtë vjet me radhë në rajon, Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka qenë në vendin e parë në përmbushjen e treguesve.

Renditja e institucioneve sipas shkallës së përmbushjes së treguesve të hapjes

RENDITJA	Qeveria dhe ministritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut	% e përmbushjes së treguesve të hapjes	Viti 2023 % e përmbushjes së treguesve të hapjes
1.	Ministria e Mbrojtjes	83% ↓	90,84%
2.	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	77,32% ↓	78,33%
3.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	76,29% ↓	85,61%
4.	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve	74,42% ↓	76,28%
5.	Ministria e Punëve të Brendshme	73,3% ↓	74,04%
6.	Ministria e Administratës Publike	68,08% ↓	71,06%
7.	Ministria e Shëndetësisë	67,52% ↑	63,78%
8.	Ministria e Transformimit Dixhital	65,65% ↓	71,06%
8.	Ministria e Financave	65,65% ↓	67,14%
10.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	65,28% ↓	66,77%
11.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	64,35% ↓	69,94%
12.	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	59,68% ↑	52,59%
NËN MESATAREN E 56,02% TË MINISTRIVE			
13.	Ministritë e Ekonomisë dhe Punës	51,1% ↓	59,31%

14.	Ministria e Drejtësisë	50,73% ↓	61,92%
15.	Ministria e Kulturës dhe Turizmit	50,73% ↓	57,25%
16.	Ministria për Çështje Evropiane	42,89%	/
17.	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	40,28% ↓	51,47%
18.	Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	36,92% ↑	25,36%
19.	Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale	34,68%	/
20.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme	26,85% ↓	69,01%
21.	Ministria e Sportit	23,12%	/

RENDITJA	Organet ekzekutive	% e përmbushjes së treguesve të hapjes
1.	Inspektorati Shtetëror Administrativ	78,48%
2.	Byroja për Furnizime Publike	77,81%
3.	Agjencia për Ushqim dhe Veterinari	74,41%
4.	Enti Shtetëror i Statistikave	71,47%
5.	Drejtoria e të Ardhurave Publike	70,11%
6.	Drejtoria doganore	64,23%
7.	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	61,97%
8.	Inspektorati Shtetëror i Punës	61,52%
9.	Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit	61,29%
10.	Drejtoria për Çështje Hidrometeorologjike	60,61%
NËN MESATAREN E 57,79% TË		

ORGANEVE EKZEKUTIVE		
11.	Arkivi Shtetëror	56,54%
12.	Drejtoria e Zbulimit Financiar	51,58%
13.	Inspektorati Shtetëror i Pylltarisë dhe Gjuetisë	46,58%
14.	Byroja për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore	46,13%
15.	Byroja për Zhvillim Rajonal	45,23%
16.	Enti Gjeologjik i RMV-së	43,44%
17.	Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale	42,96%
18.	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve	42,08%
19.	Komisioni për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare	41,61%

Përfundim i përgjithshëm që del nga institucionet e monitoruara në Indeksin e Hapjes është se **angazhimi dhe zbatimi i standardeve të hapjes janë në nivele të ndryshme midis strukturave të ndryshme të pushtetit ekzekutiv, dhe për këtë arsye koncepti i hapjes duhet të zgjidhet në mënyrë sistemore.** Prandaj, politikat qendrore, si për shembull Strategjia për Transparencën e qeverisë dhe standardet minimale të përcaktuara për transparencën dhe llogaridhënien publike, duhet të pranohen dhe të zbatohen nga të gjitha institucionet e pushtetit qendror. Është e nevojshme të ndahen burime financiare për zbatimin e kësaj Strategjie dhe të angazhohen burime njerëzore shtesë me qëllim të forcimit të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara.

3 institucionet më të hapura në Maqedoninë e Veriut



Nga matjet individuale të gjithsej 40 institucioneve, **Ministria e Mbrojtjes (83%)** mbeti institucion kryesor në Maqedoninë e Veriut për sa i përket përmbushjes së treguesve të hapjes, e këtë vit pasohet nga **Inspektorati Shtetëror Administrativ (78,48%)** dhe **Qeveria (77,32%)**. Ajo që për fat të keq është vënë re këtë vit është se Ministria e Mbrojtjes, e cila vitin e kaluar ishte institucioni më i hapur në rajon, këtë vit është në vendin e tretë në rajon.

Analiza e bazës së të dhënave të Indeksit të Hapjes, e ndarë në katër nënkategori (**transparenca, efikasiteti, integriteti dhe qasshmëria**) tregon se rezultati total i pushtetit ekzekutiv arrin **rezultatit më të lartë të përmbushjes së treguesve të transparencës prej 61,08%, ndërsa rezultat më të ulët për sa i përket qasshmërisë prej 48,79%**. Ajo që brengos është rënia prej gati 5% në nënkategorinë e qasshmërisë krahasuar me vitin e kaluar kur ishte gjithashtu në fund të renditjes, por me 54,18%..

Pushteti ekzekutiv - hapja sipas nënkategorive




Më e ulëta në shkallën e Indeksit të Hapjes në përmbushjen e treguesve është nënkategoria e **qasshmërisë**. Duhet theksuar se në këtë nënkategori përmes treguesve vlerësohet shkalla në të cilën e drejta për qasje në informacionin është e garantuar nga ligji dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për angazhimin dhe konsultimin me publikun në proceset e hartimit të politikave.

Institucionet e pushtetit ekzekutiv (duke përfshirë Qeverinë, ministrinë dhe organet ekzekutive) arrijnë një rezultat mesatar në arritjen e nënkategorisë së qasshmërisë prej 48,79%, që krahasuar me nënkategoritë e tjera është në fund të renditjes, për të dytin vit radhazi. **Rezultati mesatar ndikohet nga përmbushja e ulët e treguesve të qasshmërisë nga ministrinë (35,48%) dhe organet ekzekutive (35,58%), të cilat janë nën rezultatin mesatar të përgjithshëm në nënkategorinë e qasshmërisë. Për dallim prej tyre, Qeveria përmbushi 75.31% të treguesve të qasshmërisë.**

Sipas përfshirjes së nënkategorisë së qasshmërisë, qeveria, kryesisht, vlerësohet për cilësinë e kornizës ligjore që e e garanton të drejtën e qasjes në informata, si dhe praktikën e saj, ndërsa rezultatet e ministrive dhe organeve ekzekutive mbështeten plotësisht në masën në të cilën ato i praktikojnë dispozitat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të vëzhguara përmes Indeksit të Hapjes. Prandaj, shumica e rekomandimeve që ky dokument i nxjerr në pah, në fakt, kërkojnë zbatim efikas të politikave ekzistuese nga ministrinë dhe organet ekzekutive.

Të dhënat më poshtë japin një pasqyrë të përgjithshme të rezultateve dhe arritjeve të institucioneve për secilin parim veç e veç, edhe atë **respektimi i transparencës, qasshmërisë, efikasitetit dhe integritetit**. Indeksi ofron gjithashtu një analizë të thelluar të institucioneve individuale, si më poshtë: e vlerëson disponueshmërinë publike të informatave të organizatës, buxhetit dhe procedurave të furnizimeve publike (**transparenca**); e vlerëson shkallën në të cilën e drejta për qasje në informata është e garantuar me ligj dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmeve për përfshirje dhe konsultim në proceset e krijimit të politikave; **qasshmëria** - e shqyrton përkushtimin e institucioneve për të mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit - duke përdorur pikat/treguesit kryesorë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit; **efikasiteti**; e vlerëson praninë e mekanizmeve për parandalimin e konfliktit të interesave, rregullimin e lobimit, si dhe disponueshmërinë e kodit për sjellje etike që do ta drejtojë dhe sanksionojë sjelljen e nëpunësve shtetërorë dhe administratës publike **integriteti**. Një vlerë e shtuar e Indeksit të Hapjes është se përmes analizës së të gjitha parimeve, vlerësohet edhe puna përmes praktikimit dhe angazhimit ndaj konceptit të **të dhënave të hapura**. Rezultatet janë marrë veçmas për secilin nivel të qeverisjes (qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive), duke nxjerrë në pah shembujt e mirë që veçohen në secilin grup.

Hapja veçmas sipas institucioneve dhe nënkategorive




4.1.1 TRANSPARENCA

Transparenca është një koncept i gjerë që lidhet me disponueshmërinë e informacionit dhe me qasjen dhe përdorshmërinë e informacionit nga qytetarët, gjegjësisht kërkuesit e informacionit. E përcaktuar në këtë mënyrë, ajo e përfshin transparencën aktive, gjegjësisht publikimin proaktiv të informacionit nga institucionet publike, dhe transparencën pasive (reaktive), ku dhënia e informacionit inicohet nga kërkuesi i informacionit (përmes ushtrimit të së drejtës së qasjes në informacion). Në thelb, transparenca ndikon në uljen e korrupsionit, rritjen e pjesëmarrjes së palëve të interesuara në vendimmarrje, si dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve, gjegjësisht niveli i transparencës, ndër të tjera, ndikon në qeverisjen e mirë. Duke qenë se faqet e internetit janë burimi kryesor i informacionit për punën e institucioneve, dhe janë mjete për qasjen më të shpejtë, më të lehtë dhe më të sigurt, shumica e treguesve të Indeksit të Hapjes kanë të bëjnë me faqet e internetit si burim i informacionit.

Përmes treguesve me të cilët vlerësohet disponueshmëria publike e informacionit të organizatës, pjesëmarrja e palëve të interesuara në krijimin e buxhetit dhe transparenca në shpenzimet e buxhetit nga pushteti ekzekutiv, si dhe transparenca në procedurat e furnizimeve publike, pushteti ekzekutiv (qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) është vlerësuar me rezultatin 61,08% të përmbushjes së treguesve të transparencës. Të analizuara individualisht, ministritë që ishin të parat në krahasimin e bërë vitin e kaluar, tani janë në vendin e fundit me 59,72%. Organet ekzekutive përmbushin 60,95% të treguesve të transparencës, ndërsa qeveria, me 62,57%, është në krye të shkallës për përmbushjen e treguesve të transparencës.

TRANSPARENCA -
% e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Nënkategoria e transparencës: 3 institucionet më transparente në Maqedoninë e Veriut



Nga matja individuale e gjithsej 40 institucioneve në nënkategorinë e transparencës, Ministria e Mbrojtjes (79,6%) renditet e para, e ndjekur nga Ministria e Financave (79,24%). %)

dhe Inspektorati Shtetëror Administrativ (78,84%). **Duhet theksuar se edhe në nivel rajonal, këto tre institucione renditen edhe më lart në këtë nënkategori, gjegjësisht ato e "mbajnë" vendin e parë, të dytë dhe të tretë krahasuar me të gjitha institucionet e vlerësuara në rajon.**

Informacionet mbi buxhetin

Duke pasur parasysh që transparenca në planifikimin dhe zbatimin e financave publike është një element kyç i qeverisjes së mirë, ky Indeks i Hapjes e mat transparençën buxhetore të pushtetit qendror përmes një sërë treguesish. Në fakt, transparenca buxhetore është e rëndësishme nga aspekti i informimit të taksapaguesve, pra qytetarëve, për qëllimin për të cilin institucionet i planifikojnë dhe i shpenzojnë fondet e taksapaguesve. Për më tepër, u mat publikimi në kohë dhe sistematik i informacionit relevant fiskal, pasi kontribuon në uljen e korrupsionit, si dhe në sigurimin e pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në proceset buxhetore.

Buxheti i shtetit për vitet 2024 dhe 2025³⁸ është publikuar në faqen e internetit të Qeverisë, por mungon publikimi në format të hapur³⁹^[OBJ], si ministri kompetente, në faqen e internetit <http://budget.finance.gov.mk>, që u krijua në vitin 2017, dhe këtë vit buxheti për qytetarët është publikuar në një mënyrë të kuptueshme në formën e Buxhetit të qytetarëve, që e ndan buxhetin e shtetit sipas klasifikimit ekonomik, pastaj sipas fushës funksionale, sipas përdoruesve të buxhetit. Mbetet rekomandimi nga viti i kaluar, me qëllim të përmirësimit të konsultimeve publike gjatë planifikimit të buxhetit, të futen konsultimet publike, si dhe të publikohen informacione mbi shpenzimin e rezervave buxhetore, që u krijua në vitin 2017, dhe këtë vit buxheti për qytetarët është publikuar në një mënyrë të kuptueshme në formën e Buxhetit të qytetarëve, që e ndan buxhetin e shtetit sipas klasifikimit ekonomik, pastaj sipas fushës funksionale, sipas përdoruesve të buxhetit. Mbetet rekomandimi nga viti i kaluar, me qëllim të përmirësimit të konsultimeve publike gjatë planifikimit të buxhetit, të futen konsultimet publike, si dhe të publikohen informacione mbi shpenzimin e rezervave buxhetore.

Nga organet ekzekutive, 58% publikojnë plane financiare vjetore, e sa i përket raportimit, 84% e tyre publikojnë llogari përfundimtare, kurse vetëm katër prej tyre, Drejtoria Doganore⁴⁰, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë⁴¹, Inspektorati Shtetëror Administrativ⁴² dhe Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm⁴³, publikojnë raporte financiare periodike në faqen e tyre të internetit.

³⁸ Gjendet në <https://vlada.mk/budzet>

³⁹ Gjendet në <https://finance.gov.mk/mk-MK/oblasti/budzeti/budzet-finansii>

⁴⁰ Gjendet në <https://www.customs.gov.mk/mk-MK/pocetna/za-nas/publikacii-i-izveshtai/godishni-smetki-i-budzet.nsp>

⁴¹ Gjendet në <https://fva.gov.mk/mk/budzet>

⁴² Gjendet në <https://duinspektorat.mioa.gov.mk/mk/node/32>

⁴³ Gjendet në <https://digu.gov.mk/%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/>

Procedurat për furnizimet publike

Indeksi i Hapjes, nëpërmjet një sërë treguesish në këtë fushë, vlerësimin e arritjeve të pushtetit ekzekutiv e formon nëpërmjet planeve, thirrjeve, vendimeve, kontratave dhe shtojcave, të cilat janë të disponueshme publikisht, për furnizimet publike në faqet e internetit të institucioneve.

Disa vite me radhë, me qëllim të përmirësimit të procedurës së furnizimeve publike dhe zvogëlimit të mundësisë për keqpërdorim të mjeteve, u dha rekomandimi, i cili përsëritet edhe këtë vit, që zyrtarët që kryejnë furnizime publike të obligohen të plotësojnë deklaratë për konflikt interesash dhe të dorëzojnë fletë anketuese për gjendjen pronësore. Gjithashtu, përsëritet rekomandimi për nevojën për të shpallur publikisht emrat e pronarëve të vërtetë të kompanive ofertuese dhe të kompanive që kanë lidhur kontrata për furnizime publike, për koncesionet dhe partneritetet publiko-private, gjë që do të parandalojë korrupsionin, do të zvogëlojë ndjeshëm keqpërdorimin e ofertave për furnizime publike dhe do të shërbejë për të siguruar konkurrencë të drejtë midis ofertuesve, dhe që parashikohet edhe si masë në Planin e gjashtë Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2024-2026)⁴⁴. Edhe këtë vit mbetet rekomandimi drejtuar institucioneve për të përgatitur një raport përmbledhës vjetor për të gjitha furnizimet publike për vitin e kaluar, pasi është vërejtur një rënie e ndjeshme e arritjeve krahasuar me vitin e kaluar.

Tabela më poshtë jep një pasqyrë të shkallës në të cilën ministrinë dhe organet ekzekutive i përmbushin treguesit që e vlerësojnë transparencën në procedurat për furnizimet publike. **Ka një rënie të ndjeshme në hapjen e ministrive në këtë nënkategori krahasuar me vitin e kaluar.** Matja e këtij viti tregoi se Ministria e Sportit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nuk i publikojnë fare⁴⁵ në faqet e saj të internetit planet e furnizimeve publike, thirrjet për furnizime publike, vendimet për furnizime publike, kontratat e furnizimeve publike, si dhe raport vjetor për të gjitha furnizimet publike.

⁴⁴ Plani Kombëtar i Veprimit për PQH (2024– 2026). Marrë nga: https://ovp.gov.mk/nap_proposals/1-2-%d1%98%d0%b0%d0%b2%d0%bd%d0%be-%d0%be%d0%b1%d1%98%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%b8%d0%bc%d0%b8%d1%9a%d0%b0%d1%82%d0%b0-%d0%bd%d0%b0-%d0%b2%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b8/

⁴⁵ Si kujtesë, rezultatet i referohen një monitorimi të kryer në periudhën shkurt-maj 2025, përpara se të përgatitej dhe të promovohet faqja e re e internetit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme.

% e përmbushjes së treguesve të ministritë dhe organet ekzekutive me të cilat matet progresi në transparencën e procedurave për furnizimet publike, veçmas sipas treguesve, me një krahasim midis viteve 2024, 2023 dhe 2022.

Treguesit	Ministritë			Organet ekzekutive		
	2024	2023	2022	2024	2023	2022
A janë publikuar në faqen e internetit planet për furnizimet publike?	90 % ↓	93,75 % ↓	100%	79 % ↓	89,5% ↑	84%
A janë publikuar në faqen e internetit thirrjet për furnizimet publike?	80 % ↓	87,5%	87,5%	89,4% ↑	79% ↑	74%
A janë publikuar në faqen e internetit vendimet për furnizimet publike?	80 % ↓	87,5%	87,5%	89,4% ↑	74% ↑	68%
A janë publikuar në faqen e internetit kontratat për furnizimet publike?	80 % ↓	87,5%	87,5%	94,7% ↑	84% ↑	79%
A janë publikuar në faqen e internetit shtojcat e kontratave për furnizimet publike?	85 % ↓	93,75% ↑	87,5%	89,4% ↑	74%	74%
A është i disponueshëm në faqen e internetit versioni më i fundit i raport vjetor ⁴⁶ për të gjitha furnizimet publike?	65 % ↓	75% ↑	68,75%	57,9 % ↓	63% ↑	16%

⁴⁶ Edhe pse institucionet bënë një hap pozitiv vitin e kaluar duke integruar kryesisht pjesë të portalit për furnizimet publike në faqet e tyre të internetit, ato duhet të publikojnë raporte vjetore të veçanta për të gjitha furnizimet publike në një dokument të veçantë në format të hapur.

4.1.2. QASSHMËRIA

Indeksi i Hapjes në nënkategorinë e **qassshmërisë** shkallën e hapjes e mat përmes treguesve me të cilët e vlerëson shkallën në të cilën e drejta për qasje në informacion është e garantuar nga ligji dhe në praktikë, si dhe cilësinë e mekanizmave për angazhimin dhe konsultimin me publikun në proceset e hartimit të politikave. Institucionet e pushtetit ekzekutiv (duke përfshirë Qeverinë, ministritë dhe organet ekzekutive) arrijnë një rezultat mesatar në arritjen e nënkategorisë së **qassshmërisë**, me përmbushje të treguesve prej **48,79%**. **Rezultati mesatar, njësoj sikurse edhe vitin e kaluar, ndikohet nga përmbushja e ulët e treguesve të qassshmërisë nga ministritë (35,48%) dhe organet ekzekutive (35,58%), të cilat janë nën rezultatin mesatar të përgjithshëm në nënkategorinë e qassshmërisë. Për dallim prej tyre, Qeveria përmbush 75,31% të treguesve të qassshmërisë.**

Qasja në informacion është një komponent kyç i qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme. Qëllimi i qasjes në informata është që t'u mundësojë qytetarëve të shohin se si punon pushteti, gjegjësisht të jenë në gjendje të zbulojnë korrupsionin ose të zbulojnë mangësitë gjatë krijimit të politikave. Në këtë kuptim, informacioni të cilin e krijojnë dhe të cilin e posedojnë autoritetet publike i përket publikut. Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik⁴⁷ përcakton një detyrim për poseduesit e informatave t'u përgjigjen kërkesave për qasje në informatat me karakter publik (qasje reaktive), por gjithashtu përmban dispozita për publikimin proaktiv të informacionit, gjegjësisht publikimin e informacionit nga vetë institucioni, i njohur si transparencë aktive.


Sipas përfshirjes së nënkategorisë së qassshmërisë, qeveria, kryesisht, vlerësohet për cilësinë e kornizës ligjore që e e garanton të drejtën e qasjes në informata, si dhe praktikat e saj, ndërsa rezultatet e ministrive dhe organeve ekzekutive mbështeten plotësisht në masën në të cilën ato i praktikojnë dispozitat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të vëzhguara përmes Indeksit të Hapjes. Prandaj, shumica e rekomandimeve që ky dokument i nxjerr në pah, në fakt, kërkojnë zbatim efikas të politikave ekzistuese nga ministritë dhe organet ekzekutive.

Indeksi i Hapjes përmes faqeve të internetit i vlerëson institucionet e pushtetit qendror (qeverinë, ministritë dhe organet ekzekutive) nëse kanë informacion të përditësuar mbi ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacion; nëse ato i publikojnë kërkesat për qasje të lirë në të cilat janë përgjigjur më parë; si dhe nëse kanë një seksion të veçantë në faqen e tyre të internetit të dedikuar për ushtrimin e të drejtës për qasje në informacion, ku përmbahen informacionet relevante; nëse ato kanë publikuar një listë të përditësuar informacionesh, etj. Faqja e internetit e qeverisë i përmbush plotësisht kriteret për ushtrimin e të drejtës për qasje të

⁴⁷ Gazeta Zyrtare e RM nr. 101/2019 e datës 22.05.2019. Risi është se në vitin 2024 u iniciua një procedurë për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, por nuk ka informacion në dispozicion se pse ndryshimet nuk janë dërguar në procedurë parlamentare. Linku deri te ENER-i https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=87901 qasur për herë të fundit më 12.09.2025.

lirë, e si dobësi përsëri vihet në dukje fakti se nuk i publikon përgjigjet që i përgatit për kërkesat për qasje të lirë në informacion.

QASSHMËRISË -
% e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Nënkategoria e qasshmërisë: 3 institucionet më të qasshme në Maqedoninë e Veriut



75,31%

**Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut**



58,85%

**Ministria e Mjedisit
Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor**



55,38%

**Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe
Ekonomisë së Ujërave**

Nga matja individuale e gjithsej 40 institucioneve në nënkategorinë e qasshmërisë, Qeveria renditet e para (75,31%), e ndjekur nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (58,85%) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (55,38%). Nuk ka organ ekzekutiv në tre institucionet e para në këtë nënkategori, siç ishte rasti edhe vitin e kaluar.

Përmbyshje të treguesve të qasshmërisë nën 20%, që do të thotë shkallë të ulët të realizimit të qasjes në informacion, si dhe cilësi të dobët të mekanizmave për përfshirje dhe konsultim me palët e interesuara gjatë proceseve të hartimit të politikave vihet re në dy ministri, përkatësisht, në Ministrinë e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale me 15,38%, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme me 16,67%.

Qasje në informata

Qasja në informata është një komponent kyç i qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme. Qëllimi i tij është që qytetarët të fitojnë njohuri mbi punën e institucioneve, duke mundësuar kështu zbulimin e korrupsionit ose dobësive në procesin e hartimit të politikave. Prandaj, informacioni që e krijojnë dhe që e posedojnë institucionet publike është pronë e publikut. Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik⁴⁸ përcakton një detyrim për

⁴⁸ Gazeta Zyrtare e RM nr. 101/2019 e datës 22.05.2019. Risetë nga viti 2019 që u futën në Ligj: u zgjerua lista e poseduesve të informacionit; u krijua një listë më e gjerë e informacionit që institucionet janë të detyruara ta publikojnë në mënyrë proaktive; u përcaktua interesi publik; afati për t'iu përgjigjur një kërkesë u shkurtua në 20 ditë; u shkurtua lista e përjashtimeve nga qasja e lirë; dhe u përcaktuan kompetencat e zgjeruara të organit të shkallës së dytë me mundësinë për të zhvilluar procedurë kundërvajtëse, e gjithë kjo me qëllim që të sigurohet transparencë dhe hapje e institucioneve, që ka për rezultat qytetarin e informuar.

poseduesit e informatave t'u përgjigjen kërkesave për qasje në informatat me karakter publik (qasje reaktive), por gjithashtu përmban dispozita për publikimin proaktiv të informacionit, gjegjësisht publikimin e informacionit nga vetë institucioni, i njohur si transparencë aktive. Zbatimi i publikimit aktiv të informacionit është forcuar me miratimin e një përfundimi nga Qeveria për poseduesit e informacionit, të përfshirë me Udhëzimin për Përmirësimin e Transparencës së Institucioneve të Sektorit Publik⁴⁹, t'i publikojnë të gjitha informacionet e sistematizuara sipas fushave, për të cilat paraprakisht është konstatuar se janë informacione më të kërkuara nga qytetarët.

Indeksi i Hapjes përmes faqeve të internetit i vlerëson institucionet e pushtetit qendror (qeverinë, ministritë dhe organet ekzekutive) nëse kanë informacion të përditësuar mbi ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informacion; nëse ato i publikojnë kërkesat për qasje të lirë në të cilat janë përgjigjur më parë; si dhe nëse kanë një seksion të veçantë në faqen e tyre të internetit të dedikuar për ushtrimin e të drejtës për qasje në informacion, ku përmbahen informacionet relevante; nëse ato kanë publikuar një listë të përditësuar informacionesh, etj. Faqja e internetit e qeverisë i përmbush plotësisht kriteret për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë, e si dobësi përsëri vihet në dukje fakti se nuk i publikon përgjigjet që i përgatit për kërkesat për qasje të lirë në informacion. Kjo praktikë është vërejtur vetëm në disa ministri, përkatësisht: Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për të dytin vit radhazi, dhe për herë të parë këtë vit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Mund të konkludohet se nuk ka pasur ndonjë përmirësim të ndjeshëm në praktikë, krahasuar me vitin e kaluar, në lidhje me publikimin e përgjigjeve që ofronin qasje në informata pas një kërkesë të parashtruar në faqet e internetit.

Duke pasur parasysh trendet globale dhe proceset e digjitalizimit, të cilat po bëhen gjithnjë e më shumë një domosdoshmëri edhe në vendin tonë, pritet që theksi të vihet te transparenca aktive. Kjo qasje duhet të zvogëlojë ndjeshëm numrin e kërkesave të parashtruara në letër për qasje të lirë në informacion. Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale, ku koha e përgjigjes ndaj një kërkesë të parashtruar në letër varion midis 7 dhe 15 ditëve, grupi i punës që propozim për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik në vitin 2024, propozoi që afati të shkurtrohet nga 20 në maksimum 10 ditë. Megjithatë, në versionin e Ligjit⁵⁰ të publikuar në ENER dhe të hapur për konsultime publike në prill të vitit 2025, është parashikuar një afat prej 15 ditësh.

Për të vlerësuar kohëzgjatjen praktike të procedurës, Fondacioni “Metamorfozis”, në kuadër të monitorimit të hapjes së institucioneve, dërgoi nga një kërkesë për qasje në informata

⁴⁹ Udhëzime për përmirësimin e transparencës së institucioneve të sektorit publik. Gjendet në <https://vlada.mk/InfoJavenKarakter>

⁵⁰ Propozim-ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, i publikuar në ENER dhe i disponueshëm në https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=87901. Qasur për herë të fundit më 03.09.2025.

deri te të gjitha 40 institucionet. **Pothuajse 1/4 e institucioneve të monitoruara**, gjegjësisht 10, nuk iu përgjigjën fare kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, nga të cilat 5 ministri dhe 5 organe në përbërje të tyre, edhe atë: **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme, Ministria e Transportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Çështjeve Evropiane, Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, Inspektorati Shtetëror Administrativ; Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale, Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare dhe Byroja për Zhvillim Rajonal.**

Brenda afatit të përcaktuar ligjor, u përgjigjën 21 institucione, gjegjësisht 52,5%, nga të cilat Sekretariati i Përgjithshëm, 10 ministri dhe 10 organe në përbërje të ministrive edhe atë: Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Vetëqeverisjes Lokale; Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Transformimit Digjital; Ministria e Sportit; Ministria e Ekonomisë dhe Punës; Byroja e Furnizimeve Publike; Drejtoria e Çështjeve Hidrometeorologjike; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Drejtoria për Zbulimin Financiar; Enti Shtetëror i Statistikave; Drejtoria e të Ardhurave Publike; Byroja për Zhvillimin e Arsimit; Inspektorati Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti; Enti Gjeologjik i RMV-së dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Pas përfundimit të afatit të përcaktuar me ligj, u përgjigjën 9 institucione, nga të cilat 5 ministri dhe 4 organe në përbërje të tyre edhe atë: Ministria e Financave; Ministria e Kulturës dhe Turizmit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Administratës Publike; Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive; Drejtoria Doganore; Inspektorati Shtetëror i Punës; Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Arkivi Shtetëror.

Këtë vit, 80% e ministrive kanë krijuar një hapësirë (seksion) të veçantë të dedikuar për procedurën e kërkesave për qasje të lirë në informacion, gjegjësisht Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive e ka zbatuar gjithashtu këtë praktikë, e cila u theksua disa vite më parë. Ajo që është për t'u habitur është se ministrinë e sapokrijuara, Ministria e Sportit dhe Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale, të cilat kanë faqe të reja interneti, nuk e ndjekin këtë rekomandim. Edhe këtë vit është vërejtur **një tendencë e përforcuar në rënie për sa i përket trajnimit të nëpunësve mbi procedurën për qasje të lirë në informatat nga ministrinë.** Në tre vitet e mëparshme, përqindja e ministrive që trajnuan stafin e tyre për qasjen e lirë në informacion ishte 68,75%, pastaj 62,5%, pastaj 50%, dhe në vitin 2024, u trajnuar vetëm 15% e nëpunësve. Për herë të dytë radhazi, është vënë re se Qeveria nuk i ka trajnuar nëpunësit e saj mbi procedurën për qasje të lirë në informacion.

Sa i përket organeve ekzekutive, këtë vit u vu re se tre organe ekzekutive nuk kanë një seksion të veçantë në faqet e tyre të internetit me procedurën për qasje të lirë në informacion, edhe atë: Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisjen Lokale dhe

Komisioni për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare. Gjithashtu, u konstatua një rezultat jashtëzakonisht i dobët midis organeve ekzekutive për sa i përket personelit të trajnuar për procedurën e qasjes së lirë. Në fakt, të gjitha organet ekzekutive, përveç njërit, që është 95% dhe përsëritet për të dytin vit radhazi, raportuan se nëpunësit e tyre nuk kanë ndjekur trajnime për qasje të lirë.

Bashkëveprimi me qytetarët

Mundësitë që i ofrojnë dhe roli i mediave digjitale në komunikimin e sotëm janë të pamohueshme, veçanërisht në rrjetet sociale në shkëmbimin dhe përhapjen e informacionit, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet me interes publik, njohjen e qytetarëve me fushëveprimin e punës së institucioneve dhe hapjen e mundësive që ata të marrin pjesë në proceset e krijimit të politikave, si dhe përdorimin e thjeshtë dhe të shpejtë të shërbimeve. Prandaj, në nënkategorinë e **qasshmërisë** monitorohet shkalla në të cilën institucionet e lehtësojnë ndërveprimin dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Natyra dhe përdorimi i shpeshtë i faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera online ("Facebook", "Twitter" dhe shumë të tjera) i vendos ato në një pozicion qendror për ndërveprim me qytetarët, por monitorimi tregoi mangësi kur bëhet fjalë për përdorimin e kanaleve të shpejta të komunikimit. Kështu, qeveria nuk ka kanal të drejtpërdrejtë në faqet e internetit për komunikim online, përmes të cilit qytetarët mund të shprehin shqetësimet e tyre, të parashtrajnë kundërshtime ose ankesa, e këtë e kanë vetëm 4 (20%) e ministrive (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave) dhe 6 organe ekzekutive (31,5%). Vërehet se Qeveria ka Strategji Komunikimi (2023-2024)⁵¹.

Mediat sociale kontribuojnë në lehtësimin e komunikimit dhe ndërveprimit me publikun, megjithatë, ato nuk mund t'i zëvendësojnë në asnjë mënyrë faqet e internetit për sa i përket vëllimit të informacionit të shpërndarë. Madje 31 nga 40 institucionet qendrore të monitoruara kanë profile zyrtare në Facebook dhe 11 prej tyre kanë profile në Twitter (d.t.th. "X"). Mbetet konkluzioni nga viti i kaluar se dalëngadalë po braktiset praktika e përdorimit vetëm të profileve personale të funksionarëve si zyrtare në mediat sociale, mirëpo ato ende janë më të pasura me informata se sa kanalet zyrtare të institucioneve në mediat sociale. Problemi kryesor me profilet personale të funksionarëve është ajo se ato pushojnë së përdoruri si burim informacioni dhe ndërveprimi me institucionet përkatëse sapo të mbarojë mandati i funksionarit, dhe si të tilla ato nuk përmbajnë memorie të gjata të ngjarjeve në institucione.

Duke marrë parasysh se shoqëria civile duhet të jetë një partnere e barabartë dhe korrektuese në vendimmarrje, si dhe se nevojitet një dialog i vazhdueshëm, transparent dhe

⁵¹ Strategjia e Komunikimit të Qeverisë për vitet 2023-2024. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://vlada.mk/komunikaciska-strategjia-2023-2024>.

plotësisht gjithëpërfshirës me të, monitorimi përfshiu një shqyrtim të faqeve të internetit të ministrive për të përcaktuar nëse ato kanë publikuar informacion mbi aktivitetet e përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile në gjashtë muajt e fundit. Rezultatet tregojnë se në vitin 2024, 85% e ministrive publikojnë rregullisht përmbajtje të tillë.

Për sa i përket lehtësimit të shërbimeve publike, pushteti qendror e plotëson portalin online të shërbimeve elektronike, i cili është i disponueshëm në www.uslugi.gov.mk. Ai është një mjet që luan një rol kyç në ofrimin e shërbimeve lehtësisht të arritshme për qytetarët, si një karakteristikë e qeverisjes së mirë. Edhe pse insistohet që të gjitha e-shërbimet nga institucionet shtetërore të jenë të rrjetëzuara, të vendosura në uslugi.gov.mk, megjithatë, shërbimet e tilla ofrohen edhe në mënyra të tjera. Për shembull, e-shërbimet ofrohen individualisht edhe nga vetë ministritë. Nëpërmjet faqeve kryesore të internetit të ministrive, 75% e tyre kanë në dispozicion seksione me lista të të gjitha shërbimeve të ofruara nga ministria me linke deri te përshkrimi i shërbimit dhe dokumentacioni i nevojshëm. Ashtu si vitin e kaluar, kjo lloj liste e shërbimeve elektronike të ofruara nga organet ekzekutive nuk është publikuar në faqet e tyre të internetit.

Konsultimet publike

Përfshirja në kohë dhe thelbësore e qytetarëve në hartimin e politikave është një parakusht kyç që një shoqëri të njihet si demokratike, transparente dhe e përgjegjshme. Një pjesëmarrje e tillë ka një kontribut të dyfishtë: nga njëra anë, u mundëson palëve të interesuara të ndikojnë në politikat që i prekin drejtpërdrejt, dhe nga ana tjetër, u ofron hartuesve të politikave ide të reja, informacione relevante dhe qasje në burime të rëndësishme për procesin e formësimit të tyre. Konsultimet në këtë kontekst kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe forcimin e parimeve demokratike, dhe zbatohen në tre nivele: (1) **informimi për fillimin e procesit** që është një fazë fillestare në të cilën publiku ka një rol pasiv, por i jepet mundësia për përgatitje dhe përfshirje; (2) **konsultimet** si një proces aktiv i mbledhjes së opinioneve dhe pikëpamjeve nga palët e interesuara, që nënkupton edhe dialog të vazhdueshëm; dhe (3) **pjesëmarrja aktive** që është përfshirja e drejtpërdrejtë e palëve të interesuara në vetë krijimin e politikave.

Në vitet e fundit, në Maqedoninë e Veriut janë krijuar disa mekanizma konsultativë, me përfaqësues nga shoqëria civile që kontribuojnë në procese konsultative më dinamike, siç është Këshilli i Koordinimit dhe Monitorimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur,⁵² Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile⁵³, Grupet sektoriale e punës,⁵⁴ Këshilli për

⁵² I krijuar për të prezantuar një qasje më të strukturuar ndaj proceseve të PQH-së duke e maksimizuar pjesëmarrjen dhe angazhimin, si dhe duke e monitoruar dhe orientuar zbatimin e planeve të veprimit të PQH-së. Marrë nga: <https://cutt.ly/LKKGXcO>.

⁵³ U formua si një organ këshillimor i Qeverisë për të avancuar bashkëpunimin, dialogun dhe për të inkurajuar zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=mk/node/99>.

⁵⁴ Dialogu me BE-në Grupet sektoriale të punës. Marrë nga: <https://cutt.ly/iKKG06Y>.

Reforma në Gjyqësor⁵⁵ etj. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përfshirë shoqërinë civile në hartimin e politikave dhe në politikat strukturore në një mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe transparente. Cilësia dhe ndikimi i vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe konsultimeve publike në vitin 2024 janë shumë të kufizuara. Rreth gjysma e ligjeve të miratuara nga Kuvendi në vitin 2023 u miratuan me procedurë të shkurtuar. Përdorimi i procedurës së "flamurit evropian" nuk është konsekuent. Në një numër të madh rastesh, kjo nuk lidhet me ligjet që synonin kryesisht harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së⁵⁶.

Sa i përket akteve ligjore⁵⁷, ka disa të tilla që ofrojnë bazën për përfshirjen e publikut në proceset e hartimit të politikave, gjegjësisht e rregullojnë këtë çështje, si për shembull: Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Zhvillimin e saj⁵⁸, Kodi i Praktikave të Mira për Pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile në Procesin e Hartimit të Politikave, Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator, Udhëzimi për Mënyrën e Veprimit të Ministrive në Procesin e Zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, Rregullorja për Organizimin e Konsultimeve Publike në Fillimin e Procesit Legjislativ, etj. Regjistri i Vetëm Elektronik Kombëtar i Dispozitave (ENER) është kanali përmes të cilit zhvillohen konsultimet elektronike mbi propozimet e politikave.

Për shkak të ekzistencës së një platforme qendrore, siç është ENER, Qeveria dhe të gjitha ministritë janë vlerësuar pozitivisht për ofrimin e mundësisë për të kryer konsultime online. Megjithatë, në faqet e internetit të ministrive, përveç Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave **nuk ka një seksion të veçantë me informacionin e nevojshëm për njoftimin e proceseve të hartimit të politikave me një link të drejtpërdrejtë deri te ENER-i.** Ashtu si edhe vitin e kaluar **numri i ministrive që publikojnë thirrje për debate publike në faqet e tyre të internetit është i vogël.** Vetëm këtë vit në 4 ministri (20%), regjistruam thirrje për debate publike në faqet e tyre të internetit, por asnjëra nuk publikon plane vjetore për debate publike. Raportet nga konsultimet e kryera nuk janë publikuar në faqet e internetit të ministrive, por, megjithatë, ato janë integruar në raportet për vlerësimin e ndikimit rregullator. **Këtë vit, vetëm Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor kanë publikuar procesverbalet e debateve publike të mbajtura me palët e interesuara në faqet e tyre të internetit.** Sipas udhëzimeve për zhvillimin e planeve strategjike dhe planeve vjetore të

⁵⁵ Këshilli për Monitorimin e Reformave në Gjyqësor ka mandatin për të monitoruar zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Sektorit Gjyqësor (2024-2028) me Planin e Veprimit dhe Agjendën e Reformave 2024-2027 në seksionin 5 - Vlerat Themelore/Sundimi i Ligjit. <https://24.mk/details/konstitutivna-sednica-na-sovetot-za-sledenje-na-reformite-vo-pravosudstvoto>

⁵⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2024_en

⁵⁷ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për Referendumin dhe Format e Tjera të Deklarimit të Drejtpërdrejtë, Ligji për Punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore dhe të tjera.

⁵⁸ Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile. Marrë nga: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/Strategjia%20usvoena%2028%2012%202021.pdf>

punës⁵⁹, pritet që të sigurohet planifikimi dhe zbatimi i koordinuar i politikave qeveritare nga organet e administratës shtetërore. Megjithatë, përfundimi i përgjithshëm është se sistemi elektronik për konsultime publike nuk është shfrytëzuar në potencialin e tij të plotë, dhe nevojitet planifikim i drejtë dhe konsultime për të kufizuar përdorimin e procedurave të shkurtuara për të mundësuar kontrollimin dhe shqyrtimin efektiv të legjislacionit⁶⁰.

4.1.3 INTEGRITETI

Korrupsioni është një nga problemet më gërryese të ditëve të sotme. Kjo çon në politika publike të gabuara, i shpërdoron burimet publike, i zgjeron pabarazitë ekonomike dhe sociale, krijon pakënaqësi dhe polarizim politik dhe e zvogëlon besimin në institucionet që duhet t'i shërbejnë interesit publik.

Qasjet tradicionale, të bazuara në krijimin e sa më shumë rregullave të mundshme, pajtueshmërinë më të rreptë legjislative dhe zbatimin më të rreptë, është e qartë se kanë efikasitet të kufizuar. Shumë autorë që e hulumtojnë këtë temë arrijnë në përfundimin se përgjigja strategjike dhe e qëndrueshme ndaj korrupsionit duhet të jetë integriteti publik⁶¹.

Integriteti paraqet një ndërthurje të vlerave të individëve dhe institucionit dhe si i tillë është e vështirë të përcaktohet dhe të kontrollohet. Por, në thelb, integriteti nënkupton kryerjen ligjore, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të punëve, me anë të të cilave personat zyrtarë e ruajnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit në të cilin janë ose persona përgjegjës ose punonjës, i eliminojnë rreziqet dhe i largojnë dyshimet rreth mundësisë së shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, dhe kështu sigurojnë besimin e qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike⁶². Në vitin 2024, nuk ka pasur përparim në parandalimin e korrupsionit dhe mbetet e rëndësishme të krijohet dhe të imponohet një vizion për një strategji të integritetit publik, duke e larguar fokusin nga politikat ad-hoc të integritetit, përmes një qasjeje të bazuar në një kulturë të integritetit. Është e rëndësishme të ekzistojnë mekanizma që do t'i parandalojnë rastet nga ekspozimi ndaj ryshfetit dhe përdorimi i lidhjeve personale, deri te praktikat e përhapura të nepotizmit, favorizimit të miqve, klientelizmit, gjegjësisht keqpërdorimit të ndikimit politik që ndodh midis elitave⁶³. Disa nga këto mekanizma përfshijnë politikat e integritetit, kodet e etikës, rregullat e mbrojtjes së sinjalizuesve, mekanizmat për parandalimin e konflikteve të interesit, rregullimin e lobimit, etj.

⁵⁹ Udhëzim për mënyrën e veprimit të ministrave dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 131/18).

⁶⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2024_en


⁶¹ Rregullat dhe kushtet, OBEZH. Marrë nga: <https://www.oecd.org/termsandconditions/>.

⁶² Politika e integritetit të organeve shtetërore. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Marrë nga: <https://cutt.ly/JKKFc86>.

⁶³ Angazhimet antikorrupsion në Maqedoninë e Veriut: strategjitë për ndërtimin e një angazhimi konstruktiv. Fondacioni “Shoqëri e Hapur” në Maqedoni. viti 2020 Marrë nga: <https://cutt.ly/6KKKiBW>.

Prandaj, kjo nënkategori shihet si një mënyrë përmes së cilës mund të parandalohet dhe kontrollohet shfaqja e ndikimit politik, gjegjësisht e keqpërdorimit të pushtetit.

Nga analiza e treguesve në **nënkategorinë e integritetit** pushteti ekzekutiv përmbush **56,3%** të treguesve. Të analizuara individualisht, më lart renditet qeveria me 64,71%, e ndjekur nga ministrinë me 63,4%, dhe në fund të renditjes janë organet ekzekutive me përmbushje të treguesve të integritetit prej 40,79%.



Qeveria u vlerësua për ekzistencën dhe disponueshmërinë e politikave që ndikojnë në parandalimin e korrupsionit, ndërtimin e një sistemi integriteti, rregullat për publikimin e fletëve anketuese nga funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar për të dorëzuar të dhëna mbi statusin e tyre pronësor⁶⁴ dhe rregullat e mbrojtjes së sinjalizuesve. Krahasuar me vitin 2022 (84,6%) qeveria ka një rënie në përmbushjen e pikëve të indeksit në këtë nënkategori me 64,71%, dhe një përqindje identike përmbushjeje me vitin 2023. Në faqen e internetit të Qeverisë janë

⁶⁴ Të dhëna nga fletët anketuese për gjendjen pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Marrë nga: <https://registar.dksk.mk/old-forms?page=0&rowsPerPage=5>

publikuar Kodi i Sjelljes për Nëpunësit Administrativë dhe Kodi i Sjelljes Etike për Anëtarët e Qeverisë dhe Bartësit e Funksioneve Publike të Emëruar nga Qeveria⁶⁵ dhe është krijuar një seksion i veçantë me informacion për mbrojtjen e sinjalizuesve⁶⁶. Gjithashtu, pozitiv është vlerësimi i qeverisë se ajo ka miratuar një politikë për integritet që është, gjithashtu, e disponueshme publikisht⁶⁷. Megjithatë, ajo mori pikë indeksi negative sepse nuk ka publikuar një Raport vjetor për zbatimin e politikës për integritet dhe për shkak të mungesës së aktiviteteve edukative për nëpunësit mbi tema të tilla si konflikti i interesave, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Mund të konkludohet se nevojitet një zbatim më intensiv⁶⁸ i politikave në mënyrë që të mund të vlerësohet efikasiteti i tyre, e që do ta ndiejnë qytetarët për të cilët korrupsioni në vitin 2023 është problemi më i madh⁶⁹.

Sa i përket arritjeve të ministrive, 4 ministri (20%) nuk kanë informacion për mbrojtjen e sinjalizuesve në faqet e internetit, edhe atë Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale, Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive dhe Ministria e Sportit. Lidhur me aktivitetet edukative mbi tema të tilla si parandalimi i korrupsionit, konflikti i interesave dhe mbrojtja e sinjalizuesve gjatë vitit 2024, madje 15 ministri (75%) raportojnë se nëpunësit nuk kanë marrë pjesë në këtë lloj aktiviteti. Këtë vit, 75% e ministrive kanë publikuar politikë për integritet në faqet e tyre të internetit, gjegjësisht këtë nuk e kanë bërë Ministria e Ekonomisë dhe Punës, Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme, Ministria e Sporteve dhe Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. Këto të dhëna tregojnë se përveç se ka kornizë ligjore në fuqi, duhet të punohet për zbatimin e tij më të mirë. Zhvillimi i një shërbimi publik dhe profesional të bazuar në merita do ta rriste llogaridhënien dhe do ta parandalojë politizimin, dhe rrjedhimisht do ta zvogëlojë ndjeshëm rrezikun e konfliktit të interesave dhe korrupsionit.

Përqindja e përmbushjes së treguesit nga ministrinë (20%) dhe organet ekzekutive (10,5%) është shumë e ulët për sa i përket përgatitjes dhe publikimit të raporteve mbi zbatimin e politikave të integritetit dhe/ose çdo politike tjetër të brendshme antikorrupsion, e cila parashikon masa për të parandaluar dhe eliminuar forma të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike në institucion.

⁶⁵ Kodi. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://vlada.mk/kodeks>.

⁶⁶ Mbrojtja e sinjalizuesve. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://vlada.mk/ukazuvaci>.

⁶⁷ Politika e Integritetit e Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Marrë nga: <https://cutt.ly/0KKK6WK>.

⁶⁸ GRECO Mars 2025, Raporti i Pajtuëshmërisë për Maqedoninë e Veriut, Rrethi i Pestë i Vlerësimit – Parandalimi i Korrupsionit dhe Promovimi i Integritetit në Pushtetin Qendror (funksionet e larta ekzekutive dhe zbatimi i ligjit) dhe Shtojca e Raportit të Dytë të Pajtuëshmërisë. Marrë nga: [https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/MK_GrecoRC5\(2025\)_Shto_në_Raportin_e_2-të_të_Pajtuëshmërisë.pdf](https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/MK_GrecoRC5(2025)_Shto_në_Raportin_e_2-të_të_Pajtuëshmërisë.pdf)

⁶⁹ Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Viti 2023 Marrë nga: <https://mcms.mk/mk/za-nasata-rabota/istrazuvana-i-publikacii/istrazuvana/2506-izveshtaj-za-procena-na-korupcijata-vo-severna-makedonija-2023.html>.

4.1.4 EFIKASITETI (PLANIFIKIMI STRATEGJIK, RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI)

Efikasiteti është një vlerësim i përkushtimit të institucioneve për të planifikuar dhe mësuar nga proceset aktuale dhe për t'i përmirësuar ato përmes sistemeve të vendosura të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit– duke përdorur qëllime– tregues kyçë gjatë planifikimit strategjik dhe raportimit. Në dy nënkategori edhe atë: *raportimi* dhe *monitorimi dhe vlerësimi*, institucionet e pushtetit qendror u vlerësuan: nëse kanë dorëzuar në kohë raport për zbatimin e programit të punës; nëse kanë dorëzuar në kohë raport financiar vjetor për vitin aktual; nëse përdorin tregues të performancës gjatë formulimit të programit vjetor, gjegjësisht për raportin vjetor për punën për vitin e kaluar. Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë vlerësohet në aspektin e ekzistencës së mekanizmave dhe gjithëpërfshirjes së kornizës ligjore për planifikimin strategjik, krijimin dhe koordinimin e politikave. Duhet të merret në konsideratë se bashkëveprimi me publikun dhe përfshirja e palëve të interesuara në proceset e hartimit të politikave, si dhe vlerësimi i ndikimit të rregulloreve, janë parime të qeverisjes së mirë, e të cilat u vlerësuan në kategorinë e *qasshmërisë* ndikojnë në performancën e institucioneve.

Gjatë procesit të planifikimit strategjik, përcaktohen strategjitë dhe politikat dhe merren vendime në lidhje me prioritetet dhe objektivat kryesore, si dhe shpërndarjen e burimeve. Kjo është edhe arsyeja pse thuhet se planifikimi strategjik është një nga hapat themelorë drejt përmbushjes së misionit, gjegjësisht përgjegjësi, të një institucioni. Monitorimi i zbatimit të politikave, si dhe konsultimi publik proaktiv janë pjesë e të njëjtit grup të zhvillimit të politikave të përgjegjshme të bazuara në prova. **Në këtë nënkategori, vëmendje e veçantë i kushtohet disponueshmërisë së mekanizmave sistematikë që e vlerësojnë rregullisht ndikimin, shpenzimet dhe efektet e politikave dhe si të tilla shërbejnë për të zhvilluar plane strategjike për të ardhmen, duke u mbështetur në të dhëna si prova.**

Korniza ligjore për planifikimin strategjik, krijimin dhe koordinimin e politikave⁷⁰ është përcaktuar dhe kjo përfshin rregullore ligjore dhe nënligjore të harmonizuara që ofrojnë mekanizma dhe procedura efikase për zbatimin dhe monitorimin e procesit me kompetencë të përcaktuar në mënyrë të përshtatshme. Ministritë përgatisin plane strategjike afatmesme

⁷⁰ Ligji për Qeverinë, Ligji për Buxhetet, Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Metodologjia për Analizën dhe Koordinimin e Politikave (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 56/06), Metodologjia për planifikimin strategjik dhe përgatitjen e Programit Vjetor të Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 124/08 dhe 58/18), Udhëzim për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 131/18), Udhëzime për përgatitjen e planeve strategjike të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, Udhëzimi mbi mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit mbi zbatimin e planit strategjik dhe planit vjetor të punës (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 130/18), Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 107/13 dhe 173/17), Metodologjia për vlerësimin e zbatimit të rregullores (*Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 2013), Udhëzimi mbi mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullores (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/13), Vendim mbi formën dhe përmbajtjen e Raportit të Vlerësimit të ndikimit të rregullores (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/13), Kodi i Praktikave të Mira për Pjesëmarrjen e Sektorit Civil në Procesin e Hartimit të Politikave (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 99/11, Rregullorja për organizimin e konsultimeve publike gjatë fillimit të procesit legjislativ.

(trevjeçare) që duhet t'i përmbajnë politikat e planifikuara brenda juridiksionit të tyre dhe mbi bazën e të cilave duhet të planifikohet buxheti në fushën përkatëse. Megjithatë, ky proces zbatohet formalisht, pa i kushtuar vëmendje të mjaftueshme ndërlidhjes së prioritetëve qeveritare dhe sektoriale, aktivitetëve të planifikuara dhe të ndërmarra për periudhën e ardhshme me shpërndarjen adekuate të fondeve të nevojshme, dhe për rrjedhojë me Strategjinë për Reforma të Administratës Publike (2023-2030)⁷¹ janë parashikuar objektiva dhe masa të përgjithshme dhe specifike që e pasqyrojnë qasjen sektoriale në krijimin e politikave, planifikimin e burimeve, forcimin e kapaciteteve administrative dhe angazhimin për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian.

Planifikimi strategjik u ndihmon ministrive dhe organeve ekzekutive të planifikojnë programet, projektet dhe aktivitetet e parashikuara në Programin Kombëtar për Miratimin e Legjislacionit të Bashkimit Evropian⁷² (NPAA) në një mënyrë të strukturuar dhe në vazhdimësi, për të monitoruar realizimin e tyre dhe për t'u përshtatur me të gjitha ndryshimet. Në fakt, në planet strategjike të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore duhet t'i shtjellojnë në detaje masat dhe aktivitetet e parashikuara në NPAA, gjegjësisht të sigurojnë përputhshmërinë e të dy akteve⁷³.

Sekretariati i Përgjithshëm e ndjek një kornizë monitorimi dhe proces, sipas së cilës ata e planifikojnë dhe e raportojnë punën e tyre në bazë vjetore. Plani Strategjik i Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së për periudhën 2022 - 2024 është harmonizuar me Buxhetin e RMV-së⁷⁴. Megjithatë, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë nuk ka publikuar Raport për Zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë as për vitin 2023 e as për vitin 2024⁷⁵.

⁷¹ Strategjia për Reformën e Administratës Publike (2023-2030). E disponueshme <https://mja.gov.mk/mk-MK/dokumenti/strategji/strategjia-za-reforma-na-javnata-administracija-2023-2030-so-akciski-plan>


⁷² Bazat e të dhënave Sekretariati për Çështje Evropiane. Marrë nga: <https://cutt.ly/RKKH4QL>.

⁷³ Doracak për Planifikimin Strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://cutt.ly/LKKHC6r>.

⁷⁴ Planifikimi strategjik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga: <https://cutt.ly/PKKJffN>.

⁷⁵ Shih në: <https://vlada.mk/strateshko-planiranje> Për herë të fundit herë qasur më 12.09.2025)

EFIKASITETI -
% e përmbushjes veçmas sipas grupeve të institucioneve



Përmes **treguesve të efikasitetit**, pushteti ekzekutiv (Qeveria, ministritë dhe organet ekzekutive) është **vlerësuar me një shkallë të përmbushjes së treguesve prej 58,39%**. Individualisht, ministritë në këtë kategori janë në fund të renditjes për sa i përket përmbushjes së treguesve të efikasitetit me 44%, organet ekzekutive janë më lart me 54,47% përmbushje të treguesve dhe Qeveria është në krye me përmbushje të treguesve të efikasitetit prej 76,6%.


Mbetet e nevojshme të forcohen kapacitetet institucionale dhe njerëzore për të koordinuar procesin e planifikimit afatmesëm dhe për ta lidhur atë me strategjitë sektoriale, buxhetimin dhe planifikimin vjetor. Gjithashtu, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të sqaruar përgjegjësitë e institucioneve për hartimin e politikave, për të siguruar funksionimin e tyre të duhur dhe për të thjeshtuar linjat e raportimit, duke përfshirë edhe forcimin e rolit të Sekretariatit të Përgjithshëm⁷⁶.

⁷⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024. Marrë nga: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf

4.1.5. Të dhënat e hapura

Të dhënat e hapura në këtë hulumtim monitorohen si një shtyllë e përbashkët e qeverisjes së mirë duke vlerësuar shkallën e hapjes së të gjitha dokumenteve dhe të dhënave që janë shqyrtuar përmes Indeksit të Hapjes. Indeksi rajonal tregon rezultatet më të mira për Maqedoninë e Veriut, megjithëse ka një përmbushje modeste prej 39,56% të treguesve (individualisht Qeveria përmbush 47,93%, organet ekzekutive përmbushin 44,47%, ndërsa ministritë përmbushin 33,99% të treguesve të të dhënave të hapura).

Të dhënat e hapura - veçmas sipas grupeve të institucioneve



Themelet për të dhënat e hapura në Maqedoninë e Veriut janë hedhur, që do të thotë se vendi ka një infrastrukturë institucionale për të dhënat e hapura: portal të hapur kombëtar (data.gov.mk), si dhe politika aktuale që duhet të rishikohen për të arritur qëllimin e forcimit të ekonomisë së të dhënave duke rritur sasinë e të dhënave të mbajtura publikisht dhe të financuara publikisht që janë në dispozicion për ripërdorim, si dhe të hiqen pengesat kryesore për ripërdorim në tregun e brendshëm, duke siguruar kështu një mjedis konkurrues të favorshëm për zhvillimin e një tregu për produkte dhe shërbime të bazuara në informacion.

Një administratë publike moderne dhe efikase, e bazuar në digjitalizim, e cila ofron shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët dhe bizneset, është pjesë e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qeveria, në Programin e saj të Punës (2024-2028), vendos një qëllim drejt rritjes së numrit të të dhënave të hapura në format të përpunueshëm nga kompjuteri, përditësimit të tyre të rregullt dhe përdorimit të lirë (të ripërdorura dhe të rishpërndara pa kufizime)⁷⁷. Nevoja për digjitalizim njihet edhe në Strategjinë për Reforma të Administratës Publike (2023-2030)⁷⁸ dhe Planin e veprimit, ndërsa masat dhe aktivitetet e pazbatuara nga Strategjia për të Dhënat e Hapura, 2018–2020⁷⁹ janë përfshirë në Draft-Strategjinë për Transparencë të Qeverisë (2023-2026) dhe planin e veprimit⁸⁰. Në Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2024 - 2026), masat për të rritur grupet e të dhënave në format të hapur janë të ndërthurura në të gjitha angazhimet, gjegjësisht tema e të dhënave të hapura është horizontale.

Shumica e institucioneve (90%), njësoj si vitin e kaluar, raportojnë se nuk kanë staf të trajnuar për të përdorur dhe publikuar të dhëna të hapura, me ç'rast është e qartë se shoqëria civile luan një rol kyç në zhvillimin e kapaciteteve të sektorit publik në këtë fushë. “Metamorfozis”⁸¹ për gati dy dekada është e angazhuar fuqimisht dhe i ka mbështetur institucionet në Maqedoninë e Veriut për të zhvilluar infrastrukturën që të jenë në gjendje të mbledhin dhe të publikojnë të dhëna në formate të standardizuara për të mundësuar përdorimin dhe ripërdorimin e lirë, siç parashikohet në Strategjinë për të Dhënat e Hapura.

Nga gjithsej 40 institucione që përbëjnë mostrën e institucioneve të monitoruara nga hulumtimi ynë, vetëm dy ministri (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Ministria e Drejtësisë) raportuan se zyrtarët nga institucionet e tyre kishin aktivitete edukative/punëtori/trajnime për të dhënat e hapura në vitin 2024. Prandaj, “Metamorfozis” ka përgatitur një seri prej dhjetë mësimesh mbi të dhënat e hapura që janë të disponueshme në <https://www.data.gov.mk/pages/obuki> dhe në profilin në YouTube të "Metamorfozis", duke i ofruar kështu administratës një burim falas për bazat e të dhënave të hapura.

Renditja e institucioneve sipas shkallës së përmbushjes së treguesve për të dhënat e hapura

⁷⁷ Programi i Punës (2024-2028), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i disponueshëm në <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa-na-vladata-2024-2028.pdf>

⁷⁸ Strategjia për Reformën e Administratës Publike (2023- 2030). Gjendet në <https://ener.gov.mk/PublicDocuments/Научр%20текст%20на%20стратегията%20за%20РЈА%202023-2030 Научр id=47 version=1.pdf>

⁷⁹ Strategjia për të Dhënat e Hapura (2018 - 2020), dhe Plani i veprimit. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Marrë nga: <https://cutt.ly/jKKZPYr>.

⁸⁰ Draft-Strategjia për Transparencë e Qeverisë (2023-2026). Gjendet në <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailid=64>

⁸¹ Përveç ofrimit të trajnimit praktik për institucionet për publikimin e grupeve të të dhënave të tyre dhe organizimin e hakatoneve për të përshpejtuar kërkesën dhe përdorimin e të dhënave, Fondacioni Metamorfozis mbështeti harmonizimin e ligjit të Maqedonisë së Veriut me Direktivën e BE-së për të Dhënat e Hapura dhe Ripërdorimin e Informacionit të Sektorit Publik (2019/1024/BE) për t'i bërë proceset e të dhënave të hapura në vend më ambicioze.

Qeveria dhe ministrinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut		% e përmbushjes së treguesve të të dhënave të hapura
1.	Ministria e Mbrojtjes	52,34%
2.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	49,5%
3.	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	46,36%
4.	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve	45,1%
5.	Ministria e Financave	41,8%
	Ministria e Punëve të Brendshme	41,8%
NËN MESATAREN PREJ 40,96% TË QEVERISË DHE MINISTRIVË		
6.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	40,7%
7.	Ministria e Administratës Publike	39,6%
8.	Ministria e Shëndetësisë	37,4%
9.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	36,3%
10.	Ministria e Kulturës	36,18%
11.	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	34,14%
12.	Ministria për Çështje Evropiane	33%
	Ministria e Transformimit Digjital	33%
	Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive	33%
13.	Ministria e Drejtësisë	24,2%
14.	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	24,12%
15.	Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale	22,76%
16.	Ministritë e Ekonomisë dhe Punës	22%
17.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme	18,48%
18.	Ministria e Sportit	13,75%

Organet ekzekutive	% e përmbushjes së
--------------------	--------------------

		treguesve të të dhënave të hapura
1.	Inspektorati Shtetëror Administrativ	60,72%
2.	Byroja për Furnizime Publike	58,08%
3.	Agjencia për Ushqim dhe Veterinari	58,08%
4.	Drejtoria doganore	55,44%
5.	Drejtoria e të Ardhurave Publike	52,8%
6.	Inspektorati Shtetëror i Punës	52,8%
7.	Inspektorati Shtetëror i Ndërtimit dhe Urbanizmit	50,16%
8.	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	48,84%
9.	Enti Shtetëror i Statistikave	47,52%
10.	Drejtoria për Çështje Hidrometeorologjike	44,88%
NËN MESATAREN PREJ 44,47% TË ORGANEVE EKZEKUTIVE		
11.	Arkivi Shtetëror	42,24%
12.	Komisioni për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet Fetare	39,6%
	Byroja për Zhvillim Rajonal	39,6%
13.	Drejtoria e Zbulimit Financiar	38,5%
14.	Byroja për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore	34,32%
	Enti Gjeologjik i RMV-së	34,32%
15.	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve	31,68%
16.	Inspektorati Shtetëror i Pylltarisë dhe Gjuetisë	29,04%
17.	Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale	26,4%



**REKOMANDIME PËR
PUSHTETIN EKZEKUTIV NË
REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

Transparenca

- Të gjitha organet ekzekutive duhet të krijojnë seksione të veçanta në faqet e tyre të internetit për transparencë aktive, llogaridhënie dhe komunikim të drejtpërdrejtë me publikun, duke përfshirë kërkues funksionalë.
- Institucionet duhet të miratojnë procedura të brendshme me afate të përcaktuara qartë dhe persona përgjegjës për përditësimin dhe publikimin e rregullt të informacionit, me qëllim të avancimit të transparencës reaktive dhe aktive.
- Publikimi i programeve vjetore të punës duhet të bëhet një praktikë e detyrueshme, e ndjekur nga raporte të rregullta për zbatimin. Të zbatohet përgatitja dhe publikimi më i shpeshtë i raporteve tremujore ose gjysmëvjetore.
- Qeveria t'i publikojë dokumentet e shqyrtuara në mbledhjes si dhe transkriptet nga mbledhjet. Për më tepër, futja e transmetimit audio dhe/ose video të mbledhjeve do t'i mundësonte publikut të kishte një pasqyrë të drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes.
- Gjatë përgatitjes së buxhetit, Qeveria, gjegjësisht Ministria e Financave, duhet të organizojë konsultime publike dhe të publikojë informacion mbi përdorimin e rezervave buxhetore.
- Propozim-ligji i Buxhetit duhet t'i dorëzohet Kuvendit jo më vonë se tre muaj para përfundimit të vitit fiskal, për të mundësuar shqyrtimin në kohë dhe cilësor.
- Institucionet duhet të publikojnë rregullisht planet e tyre buxhetore, si dhe raportet financiare vjetore dhe gjysmëvjetore.
- Të rregullohet mundësia që nëpunësit që kryejnë furnizime publike të obligohen të plotësojnë një deklaratë për konflikt të interesave dhe të dorëzojnë fletë anketuese për gjendjen pronësore.
- Të sigurohet transparencë e pronarëve të vërtetë të ofertuesve dhe kompanive që marrin pjesë në furnizimet publike ose që lidhin kontrata me institucionet, duke krijuar një regjistër publik të pronarëve të vërtetë.
- Institucionet duhet t'i lidhin të dhënat që kanë të bëjnë me furnizimet publike (me link), të cilat ndodhen në Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike, me faqet e tyre të internetit.
- Institucionet duhet të marrin masa konkrete në standardizimin e furnizimeve publike.

Qasshmëria

- Institucionet duhet të publikojnë në mënyrë proaktive të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përcaktuara në Nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, duke e zbatuar Udhëzimin për Përmirësimin e Transparencës së Institucioneve të Sektorit Publik.

- Të gjitha informacionet që rrjedhin nga kërkesat për qasje në informatat me karakter publik, të cilave u është dhënë përgjigje më parë, duhet të publikohen në faqet e internetit, si dhe përgjigjet në kërkesat e parashtruara për qasje në informacion, gjë që do ta zvogëlonte përsëritjen e kërkesave identike me shkrim.

- Të shkurtohet afati maksimal për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik nga 20 në 10 ditë, duke qenë se kjo është një periudhë e arsyeshme pritjeje sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikës së vendosur rajonale.

- Organet ekzekutive duhet të krijojnë një hapësirë (seksion) të veçantë në faqet e tyre të internetit kushtuar procedurës për kërkesat për qasje të lirë në informacion, e ato që nuk kanë faqe interneti duhet t'i krijojnë ato sa më shpejt të jetë e mundur.

- Nëpunësit përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje të lirë në informacion duhet të trajnohen rregullisht mbi standardet vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim të rritjes së përqindjes dhe cilësisë së përgjigjeve.

- Institucionet duhet të fusin në përdorim kanale drejtpërdrejta të komunikimit online në ueb-faqet e tyre për ta lehtësuar bashkëveprimin me qytetarët. Kanalet duhet t'u ofrojnë qytetarëve mundësinë për të parashtruar ankesa ose propozime.

- Faqet e internetit duhet të ofrojnë udhëzime të qarta dhe t'i promovojnë mekanizmat e disponueshëm për parashtrimin e ankesave.

- Paralelisht me avancimin e faqeve të internetit, institucionet duhet të forcojnë praninë e tyre në rrjetet sociale duke publikuar rregullisht informacione mbi shërbimet dhe duke rritur ndërgjegjësimin rreth të drejtave, proceseve dhe mekanizmave më pak të njohur që janë në dispozicion të qytetarëve.

- Institucionet, veçanërisht organet ekzekutive, duhet t'i publikojnë listat e shërbimeve që i ofrojnë në faqet e tyre të internetit, si dhe të vendosin, në një vend të dukshëm, një link deri te portali www.uslugi.gov.mk. Për më tepër, institucionet duhet të rrisin promovimin e portalit www.uslugi.gov.mk në rrjetet sociale.

- Proceset e hartimit të politikave duhet të jenë të parashikueshme dhe të planifikuara paraprakisht. Planet vjetore për konsultime me palët e interesuara duhet të publikohen në faqet e internetit, të shpërndahen në kohë dhe të promovohen në mënyrë aktive, në mënyrë që publiku të jetë në dijeni të afatit kohor dhe të mund të përgatitet për pjesëmarrje. Komunikimi në kohë dhe efektiv me publikun është çelësi për një kontribut thelbësor në proceset e konsultimit.

- Institucionet duhet të krijojnë një seksion të veçantë në faqet e tyre të internetit me informacionin e nevojshëm për njoftimin e proceseve të hartimit të politikave me një link të drejtpërdrejtë deri te ENER-i.

- Të prezantohet një mekanizëm për kontrollin e cilësisë së konsultimeve publike. Për të siguruar besim në procesin e konsultimit dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen, institucionet duhet të japin informacione kthyesë nga konsultimet, gjegjësisht të krijojnë procesverbale nga proceset e konsultimit, si një aktivitet pasues me shpjegime se pse disa propozime nuk janë pranuar.

Efikasiteti

- Institucionet duhet të përdorin tregues të suksesit gjatë planifikimit dhe tregues të suksesit gjatë përgatitjes së raporteve për punën e tyre.

- Duhet të zbatohet roli i Sekretariatit të Përgjithshëm për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të politikave ekzistuese.

- Qeveria duhet ta zvogëlojë trendin e numrit të propozim-ligjeve që propozohen me procedure të shkurtuar, veçanërisht para periudhës zgjedhore, në mënyrë që të mos rrezikohet cilësia e tyre dhe/ose të ulet pjesëmarrja e palëve të interesuara në konsultime.

- Qeveria duhet t'i shmanget ndryshimit të politikave pa dëshmi se ndryshimet e propozuara do të ofrojnë përmirësime të konsiderueshme. Kërkohet angazhim dhe krijimi i praktikës për kryerjen e analizave ex ante dhe ex post.

- Të gjitha institucionet duhet ta përmirësojnë përdorimin konsekuent të të dhënave për qëllime administrative dhe në to ta bazojnë planifikimin dhe raportimin e tyre.

Integriteti

- Institucionet duhet të punojnë shpejt për përgatitjen e politikës së integritetit, e cila pritët të publikohet në faqet e tyre të internetit, si dhe t'i përkushtohen përgatitjes dhe publikimit të raporteve për zbatimin e politikave të integritetit.

- Institucionet duhet ta rrisin ndjeshëm shpeshtësinë e aktiviteteve edukative për nëpunësit për tema të tilla si konflikti i interesave, parandalimi i korrupsionit dhe mbrojtja e sinjalizuesve.

- Është e nevojshme të përmirësohet sistemi për monitorimin e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Përmirësimi i formatit në të cilin publikohen deklaratat e pasurisë në format të hapur.

- Duhet të forcohen instrumentet e monitorimit dhe raportimit në lidhje me kornizën ligjore dhe të politikave në këtë fushë, në mënyrë që të gjenerojnë të dhëna për zbatimin e saj dhe të rritet besimi në sistem.

Të dhënat e hapura

- Të avancohen politikat për të dhënat e hapura, gjë që do të sigurojë dhe garantojë publikimin dhe përditësimin e vazhdueshëm dhe të rregullt të të dhënave nga poseduesit e të dhënave, pavarësisht nga ndryshimet politike apo iniciativat individuale.

- Qeveria duhet të sigurojë burime adekuate financiare, teknike dhe njerëzore për zbatimin e politikave për të dhënat e hapura, si dhe të krijojë një sistem të qartë për monitorim dhe vlerësim që do ta monitorojë aktualitetin, cilësinë, disponueshmërinë dhe përdorshmërinë e të dhënave të publikuara.

- Të sigurohet qasje e orientuar drejt përdoruesit në Portalin për të dhënat e hapura duke futur formate të standardizuara dhe të lexueshme nga makina, si dhe mjete për vizualizim. Paralelisht, institucionet duhet ta promovojnë dhe ta mbështesin përdorimin aktiv të të dhënave nga qytetarët, bizneset, bota akademike dhe organizatat e shoqërisë civile.

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis është fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Misioni i tij është të kontribuojë për zhvillimin e demokracisë dhe për rritjen e cilësisë së jetës përmes shfrytëzimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Fushat programore në të cilat punon Fondacioni “Metamorfozis” janë:

- Transformimi digjital i përgjegjshëm
- Përgjegjësia shoqërore
- Integriteti i mediave dhe informacionit

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”

Rr. "Franklin Ruzvellt" Nr. 19, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Македонија

e-mail: info@metamorphosis.org.mk

tel: +389 2 3109 325

www.metamorphosis.org.mk

